



REGIONAL
ANTI-CORRUPTION
INITIATIVE



THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe

**“Zbatimi efektiv i masave për kthimin
e pasurisë në Ballkanin Perëndimor:
vështrim i përgjithshëm i
metodologjisë rajonale të monitorimit,
standardet kryesore dhe rastet e
studimit të praktikave të mira”**

Ekipi i Projektit

Znj. Biljana Braithwaite

Drejtoreshë e Projektit, Qendra AIRE Programi për Ballkanin Perëndimor

Z. Vladan Joksimović

Drejtoreshë e Projektit, Shef i Sekretariatit të RAI

Znj. Desislava Gotskova

Administratore e Projektit

Koordinatorët Kombëtar të Projektit:

Profesor Eldan Mujanović

Ekspert drejtues i Raportit, Univeristeti i Sarajevës, B dhe H

Znj. Ledina Mandia, PhD

Avokate dhe Lektore, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Znj. Ganimete Ismajli

Lektore, Kolegji AAB, Kosovë

Z. Aleksa Ivanović


Kryetar i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Mal i Zi

Znj. Mirjana Lazarova-Trajkovska, PhD

Gjyqtare e Gjykatës së Lartë e Maqedonisë së Veriut


Znj. Radmila Dragičević-Dičić

Gjyqtare e Gjykatës së Lartë të Kasacionit të Serbisë



“Zbatimi efektiv i masave për kthimin
e pasurisë në Ballkanin Perëndimor:
vështrim i përgjithshëm i metodologjisë
rajonale të monitorimit, standardet
kryesore dhe rastet e studimit
të praktikave të mira”

Maj 2020



PËRMBLEDHJE

Raporti, “Zbatimi efektiv i masave për kthimin e pasurisë në Ballkanin Perëndimor: vështrimi i përgjithshëm i metodologjisë rajonale të monitorimit, standardet kryesore dhe rastet e studimit të praktikave të mira” është zhvilluar në kuadër të projektit rajonal, “Forcimi i punës kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor përmes përmirësimit të masave për konfiskimin e pasurisë”. Projektin e zbatojnë Qendra AIRE (Këshilla për të Drejtat Individuale në Evropë) dhe Sekretariati i RAI (Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit). Projekti financohet nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

Në këtë raport përfshihen juridiksionet si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova*, Mali i zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Raporti përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë është vështrimi i përgjithshëm i metodologjisë rajonale të monitorimit, praktika më e mirë dhe hapat e mëtejshëm dhe paraqet standardet më të rëndësishme të cilat rrjedhin nga burimet ndërkombëtare, në veçanti nga Bashkimi Evropian. Sipas analizës së kryer në këtë vështrim të përgjithshëm është përgatitur një listë e standardeve dhe e rekomandimeve, me qëllim që t’i ofrojë autoriteteve vendase të secilit juridiksion të përfshirë udhëzime të vlefshme dhe praktike për krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës, të saktë dhe të besueshëm për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave për kthimin e pasurisë. Si për vështrimin e përgjithshëm ashtu edhe për listën e standardeve dhe të rekomandimeve janë zhvilluar konsultime me grupet e interesit vendase nga juridiksionet pjesëmarrëse. Të dhënat statistikore të mbledhura nga koordinatorët kombëtarë në secilin juridiksion janë paraqitur në Shtojcën I.

Pjesa e dytë e raportit paraqet historitë e suksesit, të cilat janë prezantuar në formën e rasteve të studimit. Rastet e studimit përqendrohen në aspektet e ndryshme të procesit të kthimit të pasurisë siç është konfiskimi nga palët e treta, standardet e marrjes së provave, hetimet financiare dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Historitë e suksesit mund të shfrytëzohen si material trajnimi por mund të prezantohen dhe të promovohen edhe më tutje në mënyrë që të forcojnë besimin e publikut tek gjyqësori dhe të krijojnë një perceptim pozitiv të publikut lidhur me efikasitetin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Qendra AIRE dhe Sekretariati i RAI dëshirojnë të falënderojnë Prof. Dr.sc. Eldan Mujanović – koordinator kombëtar i projektit për B dhe H – për përkushtimin dhe punën e tij të zellshme në përgatitjen e vështrimit të përgjithshëm të metodologjisë rajonale të monitorimit dhe koordinatorët kombëtarë të projektit: Ledina Mandia PhD (Shqipëri), Ganimete Ismajli (Kosovë*), Aleksa Ivanović (Mali i zi), gjyqtaren Mirjana Lazarova Trajkovska (Maqedonia e Veriut) dhe gjyqtaren Radmila Dragičević Diçiq (Serbi) për kontributin dhe përpjekjet e tyre në mbledhjen dhe përpilimin e informacionit të vendit.

* Ky emërtim nuk i paraqjkon qëndrimet lidhur me statusin dhe është në pajtueshmëri me Rezolutën 1244 të KSKB dhe me opinionin e GJND-së lidhur me Deklaratën e Pavarësisë të Kosovës

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË – VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I METODOLOGJISË RAJONALE TË MONITORIMIT – PRAKTIKAT MË TË MIRA DHE HAPAT PËR TË ECUR PËRPARA	7
--	----------

Hyrje.....	7
-------------------	----------

1. Standardet përkatëse dhe praktika më e mirë në regjistrimin statistikor të kthimit të pasurisë	10
1.1 Pasqyrë e përgjithshme	10
1.2 Përpjekjet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e sistemeve të harmonizuara statistikore lidhur me kthimin e pasurisë	11
2. Mekanizmat për regjistrimin statistikor të kthimit të pasurisë në rajon	13
2.1 Vështrim i përgjithshëm i juridiksioneve	13
3. Standardet drejt krijimit të mekanizmave të përshtatshëm statistikor për kthimin e pasurisë në rajon	20
4. Baza për mbledhjen e të dhënave statistikore	23

PJESA II – HISTORITË E SUKSESSHME	24
--	-----------

1. Rast studimi për Shqipërinë – Konfiskimi nga pala e tretë	24
2. Rast studimi për Bosnjën dhe Hercegovinën – Hetim financiar dhe bashkëpunim ndërkombëtar	26
3. Rast studimi për Kosovën* - Një rast i profilit të lartë i kthimit të pasurisë	28
4. Rast studimi për Malin e zi – Konfiskim i zgjeruar	30
5. Studim i rastit në Maqedoninë e Veriut – Konfiskimi i mjeteve dhe i të ardhurave nga krimi	31
6. Rast studimi për Serbinë – Standardet e të provuarit	34
Shtojca 1 – Pasqyrë statistikore e të dhënave për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar në rajon.....	37
Referencat.....	44

PJESA E PARË – VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I METODOLOGJISË RAJONALE TË MONITORIMIT – PRAKTIKAT MË TË MIRA DHE HAPAT PËR TË ECUR PËRPARA

Hyrje

Masat për kthimin e pasurisë janë një nga instrumentët më të vjetër ligjor në dispozicion të institucioneve ligjzbatuese në përgjigjen e tyre të drejtësisë penale ndaj sjelljeve që kërkojnë përfitime materiale në mënyrë të paligjshme. Sot, kthimi i pasurisë është prioritet kryesor i bashkësisë ndërkombëtare dhe është përfshirë në Objektivat e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ), në mënyrë specifike në OZHQ-16.4 (Promovimi i Shoqërive Paqësore dhe Gjithëpërfshirëse për Zhvillim të Qëndrueshëm, Institucione të Përgjegjshme dhe Gjithëpërfshirëse në të gjitha Nivelet), si edhe në zbatimin e Planit të Veprimit të Addis Ababa mbi Financimin për Zhvillim. Si rezultat i përpjekjeve të tilla, UNODC, i cili është përgjegjës për instrumentët më të spikatur të KB lidhur me krimin, ka filluar të identifikojë praktikën e mira në menaxhimin dhe kontrollin e pasurisë së rimarrë dhe të kthyer në mbështetje të një zhvillimi të qëndrueshëm më të gjerë.

Ndërsa prania e kthimit të pasurisë për dekada të tëra dhe shfrytëzimi i kthimit të pasurisë në kuadër të legjislativioneve kombëtare ka sjellë një numër të perceptimeve të dobishme dhe ka skicuar drejtimit e mundshme për përmirësimet e mëtejshme legjislativ, efikasiteti i kthimit të pasurisë në praktikë ende mbetet çështja kryesore. Kjo mund të realizohet duke shfrytëzuar metoda të shumëllojshme, ku masa kyçe e efikasitetit është përmbledhja e rasteve që janë përfunduar në institucionet gjyqësore, përfshirë prokuroritë por në veçanti gjykatat. Një përmbledhje e tillë do të përfshinte numrin e rasteve të ngritura kundër subjekteve të së drejtësisë penale, natyrën e veprave penale për të cilat ata janë ndjekur penalisht dhe një regjistër të pasurive të konfiskuara, duke përfshirë shumën, llojin (të luajtshme, të paluajtshme, të prekshme, të paprekshme, etj), dhe një vlerësim të vlerës. Në një raport lidhur me të dhënat statistikore për kthimin e pasurisë, Europol (2016) sugjeron që “të dhënat dhe statistikën lidhur me kthimin e pasurisë (d.m.th., numri dhe vlera e pasurisë së bllokuar, të sekuestruar ose të konfiskuara) janë thelbësore në mënyrë që të monitorohet funksionimi i sistemeve për kthimin e pasurisë dhe teknikat e hetimit të përdorura në hetimet komplekse që përfshijnë korrupsionin dhe krimin e organizuar «.

Edhe pse kjo duket si detyrë e thjeshtë, nuk është e pazakontë që mekanizmat kombëtarë për monitorim statistikor të organeve zyrtare shoqërore të hasin në probleme dhe pengesa të konsiderueshme që e vështirësojnë ardhjen në përfundime të sakta dhe të besueshme lidhur me atë se sa është efektiv sistemi i kthimit të pasurisë në përgjithësi. Së pari, për shkak të faktit që shtete të ndryshme e kanë legjislativionin e tyre në këtë fushë, në kuadër të së cilës kthimi i pasurisë përkufizohet si masë specifike, duhet të merren parasysh sanksionet (gjoba), pasojat e ndëshkimit ose diçka tjetër. Së dyti, mekanizmat zbatues për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë që paligjshme janë po ashtu një lidhje shumë e fuqishme në zinxhirin e sundimit të ligjit dhe kjo çështje zakonisht i nënshtrohet kuadrit ligjor i cili nuk rrjedh medoemos kryesisht nga legjislativioni penal por kanë ndikim vendimtar në efikasitetin e një kuadri ligjor penal të kthimit të pasurisë. Për shembull, një studim i kryer në MB (Bullock, 2010) ka treguar që problemet lidhur me ekzekutimin e suksesshëm të urdhrave për konfiskim mund të kenë të bëjnë me (a) vlerën e urdhrit (nëse do të ishte më e madhe se shpenzimet që do të shkaktohesh-

in nga ekzekutimi atëherë ka logjikë të bëhet zbatimi), (b) njohuritë e specializuara të personelit që punon në institucionet që e kanë për detyrë zbatimin e urdhrave të konfiskimit, (c) pengesat administrative në komunikimin ndërmjet institucioneve të përfshira, gjë e cila mund të shkaktojë humbje të kohës dhe vonesa të konsiderueshme dhe (d) mungesën e bashkëpunimit ndërmjet agjencive dhe qasjen kokë më kokë të përbashkët nga një numër i institucioneve të përfshira. Prandaj, kur bëhet fjalë për instrumentet për kthimin e pasurisë, mekanizmat për regjistrimin e statistikave duhet të përqendrohen në zbatimin e vendimeve të gjykatës.

Të dhënat për zbatimin e vendimeve të gjykatës, të cilat urdhërojnë masa të konfiskimit, janë pjesë e rëndësishme e analizës statistikore të seancës gjyqësore për konfiskimin e të ardhurave nga krimi. Nëse informacionet e mbledhura analitike nuk përputhen me gjendjen aktuale në terren, për shembull nëse nuk mund të vërtetohet saktësisht dhe në mënyrë të besueshme cilat pasuri (dhe vlerat e tyre) janë bërë pronë e shtetit (juridiksionit) pas seancës përfundimtare gjyqësore, atëherë efikasiteti i tërë sistemit për kthimin e pasurisë, i përbërë nga një numër i institucioneve të ndryshme pjesëmarrëse, mund të vihet në pikëpyetje (Datzer, Mujanoviç, 2017). Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur konfiskohet një pasuri me një vlerë më të lartë, si pjesë e luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimit të madh financiar. Në rastet e tilla, përqendrimi duhet të jetë në të siguruarit që urdhrat e nxjerrë për subjektet e krimeve të rënda të organizuara të zbatohen si duhet, meqë diçka e tillë do të ndihmojë në kompensimin e shumave të mëdha dhe të dërgojë sinjale që krimi nuk shpaguehet (Bullock, Mann, Street & Coxon, 2009).

Përfitimet nga krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës, të saktë dhe të besueshëm për regjistrimin e statistikave, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave për kthimin e pasurisë, nuk janë vetëm zbatimi i ligjeve për kthimin e pasurisë. Kjo po ashtu e forcon besimin e publikut në punën e institucioneve, në veçanti të policisë, prokurorëve, gjykatave dhe të agjencisë për menaxhimin e pasurisë, sidomos duke e bërë më të dukshme punën e tyre (Misoski, 2018). Në studimin e saj për praktikën e ndryshme të konfiskimit lidhur me pasuritë e paligjshme, Vettori (2006) ka theksuar që mungesa e statistikave të besueshme lidhur me zbatimin e dispozitave të konfiskimit e pengon rishikimin e efektivitetit dhe të efikasitetit të politikave në këtë fushë, kështu që bëhet vështirë të përcaktohet nëse masat i kanë arritur rendimentet / rezultatet e tyre të pritshme. Ky argument është veçanërisht i rëndësishëm për këtë raport, i cili do ta trajtojë ekzistencën e mekanizmave të përshtatshëm për monitorimin statistikor të rasteve në të cilat janë përdorur dispozitat e legjislacionit të ndryshuar për kthimin e pasurisë. Pjesa më e madhe e juridiksioneve të përfshira i kanë aprovuar ligjet e reja ose e kanë modernizuar legjislacionin ekzistues që e rregullon kthimin e pasurisë, si edhe kanë futur në përdorim instrumente të reja të konfiskimit (d.m.th. konfiskimi dhe sekuestrimi i zgjeruar në mungesë) dhe është me rëndësi të posaçme ekzistenca e mekanizmave gjithëpërfshirës, të përhershëm dhe të besueshëm për monitorimin e ndikimit të këtyre politikave të reja. Është e qartë që të dhënat statistikore janë tregues i rëndësishëm i përkushtimit institucional dhe mund ta përqendrojnë punën drejt një përdorimi më efikas të instrumenteve për kthimin e pasurisë. Megjithatë, është po ashtu shumë e rëndësishme të kuptohet nëse agjencitë e çmojnë vlerën e konfiskimit thjesht vetëm përtej vlerës monetare të pasurisë së kthyer dhe në çfarë rastesh e bëjnë këtë dhe deri në çfarë mase mund ta shohin potencialin parandalues dhe shkatërrues të kthimit të pasurisë (Chistyakova, Wall & Bonino, 2019).

Statistikat e drejtësisë penale në Ballkanin Perëndimor në mënyrë tradicionale regjistrohen dhe mbahen në nivel kombëtar dhe kryesisht përqendrohen në treguesit që kanë të bëjnë me numrin e rasteve të ndjekura penalisht në faza të ndryshme të procedurës gjyqësore (hetimi, aktakuza, gjykimi), me numrin e personave të dënuar, me strukturën e veprave penale dhe ndoshta me karakteristikat demografike të personave të përfshirë (gjinia, mosha, arsimimi) dhe me shpeshhtësinë e kryerjes së përsëritur të veprës penale (recidivizmi). Nganjëherë, në këto statistika përfshihen të dhëna të tjera të dorës së dytë që i referohen punës së sistemit të drejtësisë penale, siç janë të dhënat e dënimit lidhur me numrin e personave të burgosur, numri i objekteve të sekuestruara (p.sh. automjetet motorike),

por shpesh këto të dhëna nuk janë të përpunuara në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse. Studimet statistikore kombëtare lidhur me të dhënat për kthimin e pasurisë trajtohen në mënyrë të ngjashme dhe nganjëherë lidhen me monitorimin e masave të tjera në veprimtarinë e gjyqësorit. Për shembull, statistikave mund të përmbledhin numrin e rasteve në të cilat janë sekuestruar disa pasuri, por të cilat mund të përfshijnë pasuri të përdorura si prova në gjykatë, të cilat mëpas i kthehen pronarit prej të cilit janë sekuestruar përkohësisht. Nganjëherë të dhënat për sekuestrimin mund t'u referohen gjërave të përdorura për kryerjen e një krimi apo që duan të përdoren për atë qëllim dhe të cilat mund të përdoren përsëri nëse gjykata nuk i konfiskon ato përgjithmonë, gjë të cilën nuk do ta bëjë përveçse për ndonjë arsye të posaçme të sigurisë apo morale ato duhet të konfiskohen përgjithmonë pas procesit penal. Ekzistojnë po ashtu shembuj kur vendimi i gjykatës në lidhje me një padi pronësie të një pale të dëmtuar regjistrohet në analizat statistikore dhe më pas i shtohet të dhënave të cilat duhet të masin efektivitetin e sistemit për kthimin e pasurisë. Për shkak të parregullsive të përmendura, këto të dhëna thjesht nuk e pasqyrojnë efektivitetin e sistemit.

Së fundi, juridiksionet në rajon kanë kaluar nëpër reforma të ndryshme të sistemeve të tyre të drejtësisë penale, të cilat në disa raste kanë përfshirë ndryshime lidhur me atë se kush ka juridiksion t'i kryejë shqyrtimet statistikore të punës së gjyqësorit. Më parë, këtë rol e kanë kryer kryesisht institucionet statistikore të shtetit, me përfshirjen e mundshme të institucioneve të tjera në hartimin e përmbledhjes së statistikave lidhur me punën e sistemit të drejtësisë penale. Ky sistem i organizimit e ka krijuar një metodologji unike për mbajtjen e buletineve statistikore (p.sh. buletin e njohur "Personat e kallëzuar, të akuzuar dhe të dënuar"), të cilat janë ende të pranishme në disa juridiksione sot. Tani, reformat kanë çuar drejt ndryshimeve të cilat përfshijnë fuqizimin e ministrive të drejtësisë, agjencitë për menaxhimin e pasurisë dhe organet rregulluese të gjyqësorit (Këshillat gjyqësorë dhe të prokurorisë) për t'u marrë me mbledhjen e statistikave, përpunimin dhe publikimin e të dhënave. Statistikat zyrtare për punën e sistemit të drejtësisë penale në fushën e kthimit të pasurisë nuk janë më vetëm çështje e përpjekjeve vendase për shuarjen e krimit. Ndërkombëtarizimi i krimit, heqja ose zvogëlimi i intensitetit të kontroleve kufitare, shpejtësia dhe thjeshtëzimi i lëvizjes së njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, në mënyrë të pashmangshme ka hapur perspektiva të reja për autorët e krimit, në veçanti të krimit të organizuar për përfitim financiar. Ballkani Perëndimor nuk bën përjashtim nga kjo dhe ka pasur gjithnjë e më shumë incidente të zhvendosjes së pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme nga një juridiksion në tjetrin, në radhë të parë në mënyrë që të fshihet prejardhja e vërtetë e pasurisë. Autoritetet vendase në rajon janë të detyruara të shkëmbejnë informacionet dhe të dhënat në nivel operativ për qëllime të zbatimit të ligjit dhe të zbulimit dhe të sekuestrimit/konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, dhe kjo po ashtu shtrihet po ashtu edhe tek shkëmbimi i statistikave lidhur me pasurinë e konfiskuar për qëllime të planifikimit strategjik dhe të harmonizimit në rajon në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe të formave të rënda të krimit financiar. Në këtë çështje nuk ndikojnë vetëm problemet e zakonshme të ndarjes së të dhënave në kornizën institucionale kombëtare por po ashtu edhe nga ato të aranzhimeve ndërkufitare. Dihet që disponueshmëria e statistikave për konfiskimet duket po ashtu të jetë problematike. Edhe pse shumë vende paraqesin statistika të njëfarë lloji, për shumicën prej tyre të dhënat janë të pjesshme dhe nuk janë në dispozicion të publikut (Qendra për studimin e demokracisë, 2014).

Ky raport i paraqet standardet më të rëndësishme të sundimit të ligjit, të cilat rrjedhin nga burimet ndërkombëtare, në veçanti nga Bashkimi Evropian, si edhe nga praktikat më të mira që mund të shërbejnë për përmirësimin e punës në juridiksionet e përfshira në këtë projekt. Ngjashmërisht, raporti skicon mekanizmat statistikorë sipas të cilëve janë mbledhur informacionet lidhur me rastet në të cilat është zbatuar kthimi i pasurisë, me të gjithë të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe të shpërndara nga institucionet kompetente. Kjo është bërë në bazën e asaj që do të jetë e mundur të identifikohet ekzistenca e disa boshllëqeve të mundshme, mungesave dhe papajtueshmërisë me standardet përkatëse.

Kjo pjesë e raportit po ashtu përfshin një vështrim të përgjithshëm ose, në rastet kur është e mundur, një bazë për secilin juridiksion që përmban një numër të rasteve dhe të vlerës së pasurisë së sekuestruar/konfiskuar nga gjykatat kombëtare, të cilat nuk do të kenë vetëm përmasa ilustruese por edhe treguese në aspektin e identifikimit të mangësive potenciale në prezantimin e të dhënave përkatëse për sekuestrimin dhe konfiskimin.

Së fundi, analiza e zhvilluar në raport ofron mundësi për hartimin e një liste të standardeve dhe të rekomandimeve për përmirësim, me qëllim që të informojë autoritetet vendase në secilin juridiksion të përfshirë dhe të ofrojë informacione të mëtejshme lidhur me mënyrën se si krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës, korrekt dhe të besueshëm për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave për kthimin e pasurisë, është një pjesë e rëndësishme e funksionimit të sistemit të përgjithshëm të drejtësisë penale dhe çfarë nënkupton qartazi kjo ndërhyrje teknike për vendosjen e shtetit ligjor dhe procesin e integritetit në BE.

1. Standardet përkatëse dhe praktika më e mirë në regjistrimin statistikor të kthimit të pasurisë

1.1 Pasqyrë e përgjithshme

Kuadri ligjor i cili rregullon kthimin e pasurisë në kuadër të legjislacioneve kombëtare, i nënshtrohet risive të vazhdueshme, kryesisht me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të normave ligjore në këtë fushë. Megjithatë, zgjidhjet që ekzistojnë sot janë në masë të madhe rezultat i zhvillimit të kuadrit ligjor ndërkombëtar, i cili në aspektin e kthimit të pasurisë filloi të paraqitej në fund të viteve 1980, në veçanti si pjesë përbërse e luftës kundër trafikimit ndërkombëtar të narkotikëve. Në kontekst të këtij raporti, duhet të theksohet që traktatet ndërkombëtare të aprovuara në kuadër të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe më vonë Bashkimit Evropian, janë burime të vërteta të ligjit në këtë fushë, por të cilat vetëm deri në një shkallë të vogël merren me çështjen e krijimit të një sistemi për monitorimin statistikor të rasteve në të cilat është zbatuar kthimi i pasurisë. Kështu, këto traktate kanë në fokus dispozita materiale dhe procedurale, të cilat do ta siguronin një nivel të dëshirueshëm të legjislacionit kombëtar në këtë fushë, në mënyrë që ta rrisin bashkëpunimin ndërmjet shteteve në njohjen dhe zbatimin e vendimeve për sekuestrim të përkohshëm apo të përhershëm të pasurisë.

Ndër disa burime universale, duhet të theksohet Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, meqë ajo përmban një dispozitë të përgjithshme në nenin 61.2, e cila përcakton që shtetet anëtare duhet të marrin parasysh zhvillimin dhe ndarjen e statistikave me njëra tjetrën përmes organizatave ndërkombëtare dhe rajonale; në mënyrë që t'i zhvillojnë, për aq sa është e mundur, përkufizimet, standardet dhe metodologjitë e përbashkëta, si edhe informacionet për praktikën më të mira për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Kjo dispozitë fakultative nuk iu referohet në mënyrë të qartë mekanizmave për monitorim statistikor të përdorimit të kthimit të pasurisë në veprat penale të korrupsionit, por mund të shërbejë si bazë për krijimin e mekanizmave të tillë.

Këtu duhet të theksohet rëndësia e disa organizmave të ndryshme për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të disa traktateve të caktuara ndërkombëtare në lidhje me kthimin e pasurisë (d.m.th. Moneyval ose GRECO të cilat veprojnë në kuadër të Këshillit të Evropës), të cilat po ashtu merren me çështjet e regjistrimit të statistikave si pjesë e aktiviteteve të tyre. FATF-GAFI është organ ndërqeveritar i themeluar më 1989 nga ministrat e anëtarëve të tij (prej të cilëve 39 janë shtete anëtare dhe shumë vëzhgues dhe bashkëpunëtorë). Objektivat e FATF janë të caktojë standarde dhe ta promovojë zbatimin efektiv të masave ligjore, rregulluese dhe operacionale për luftimin e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit dhe të kërcënimeve të tjera lidhur me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar. Rekomandimet e FATF janë sigurisht standardet më të njohura të zbatuara në tërë

botën që kryesisht shërbejnë për t'i harmonizuar qasjet dhe praktikatat. Rekomandimi 33 i FATF (2012) kërkon nga shtetet, në mes tjerash, të mbajnë statistika gjithëpërfshirëse lidhur me ndonjë pasuri të ngrirë, të sekuestruar dhe të konfiskuar. Meqë ato lidhen me masat e përkohshme dhe konfiskimin, do të ishte e dobishme nëse statistikat e tilla zbrërthehen sipas vitit dhe, për aq sa është e mundur, i përfshijnë artikujt në vijim:

- a) numrin e veprimeve të ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit dhe shumatat apo vlerat e përfshira, lidhur me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe të 21 kategorive të caktuara të veprave bazë, të mbledhura në atë mënyrë që të sigurojnë që nuk do të ketë numërim të dyfishtë të statistikave lidhur me veprat e pastrimit të parave dhe të veprës së nënkuptuar bazë;
- b) një zbrërthim nëse rastet e tilla janë të vendit apo lidhen me kërkesat e huaja;
- c) statistikat lidhur me nivelin e përgjithshëm të kriminalitetit në vend lidhur me 21 kategoritë e caktuara të veprave bazë;
- d) një zbrërthim të statusit dhe / ose të rezultatit përfundimtar të veprimeve të tilla (p.sh. i pazgjdhur, prona e liruar, prona apo vlera e konfiskuar);
- e) një zbrërthim të shumave të urdhëruara në procedurën e konfiskimit dhe shumatat të cilat janë kthyer në të vërtetë.

Statistikat e tilla do të tregojnë nëse masat e përkohshme dhe konfiskimi janë duke u ndjekur dhe zbatuar në mënyrë sistematike dhe nëse janë duke u kthyer të ardhurat në të vërtetë, në mënyrë që t'u jepet ndihmë vendeve që i regjistrojnë ato për ta vlerësuar efektivitetin e regjimeve të tyre. Në mes tjerash, është e qartë që ky rekomandim i FATF ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në krijimin e dispozitave për monitorimin statistikor të rasteve kur është zbatuar kthimi i pasurisë, kryesisht për shkak të përdorimit të shprehjeve si “rezultati përfundimtar i veprimeve të tilla” dhe “në të vërtetë ka kthyer shumata të pasurisë “. Kjo ka treguar për nevojën që të krijohen mekanizma që vërtetë të monitorohet rezultati i procedurave në të cilat është zbatuar kthimi i pasurisë, pavarësisht nëse ishte sekuestrim/konfiskim i përkohshëm apo i përhershëm, sepse vetëm në këtë mënyrë, përmes monitorimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, mund të vërehet pasqyra e vërtetë e gjendjes aktuale dhe efektiviteti dhe efikasiteti i punës së institucioneve të drejtësisë penale.

1.2 Përpjekjet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e sistemeve të harmonizuara statistikore lidhur me kthimin e pasurisë

Burimi i parë mbi kombëtar i ligjit që e ka krijuar një sistem për regjistrimin statistikor të rasteve, në të cilat është zbatuar kthimi i pasurisë, ishte Direktiva e BE-së 2014/42 mbi ngrirjen dhe konfiskimin e mjeteve dhe të ardhurave nga krimi në Bashkimin Evropian. Në preambulën e këtij dokumenti thuhet qartë që statistikat ekzistuese në këtë fushë në shtetet anëtare janë të kufizuara. Studimet në terren kanë treguar që edhe ato vende (p.sh. Greqia) të cilat e kanë harmonizuar legjislacionin e tyre dhe kornizat institucionale me këtë Direktivë, ende nuk i mbajnë statistikat për masat e kthimit të pasurisë dhe nuk kanë qasje në bazat e të dhënave të posaçme për kthimin e pasurisë. Studimet e këtuja e kanë treguar rëndësinë dhe nevojën për një kornizë institucionale që do t'ua mundësonte monitorimin dhe regjistrimin e përpjekjeve të tilla për kthimin e pasurisë dhe nevojën për një sistem elektronik që do ta mundësonte futjen e të dhënave, dhe prodhimin dhe analizën e statistikave lidhur me përpjekjen për kthimin e pasurisë (OECD, 2018). Disa shtete të tjera anëtare (p.sh. Franca) më herët kanë krijuar baza elektronike të të dhënave për mbledhjen e të dhënave statistikore, përfshirë informacionet për karakteristikat e pasurive, numrat e lëndëve, hollësitë identifikuese dhe dosjet gjyqësore me të cilat janë të lidhura ato. Qëllimi ishte përmirësimi i statistikave, lehtësimi i punës së shfrytëzuesve dhe rritja e sigurisë (UNODC, 2017). Dispozitat që kanë të bëjnë me statistikat në Direktivë arsyetohen me nevojën për ta monitoruar, në mënyrë të tillë të harmonizuar, suksesin e zbatimit të saj në shtetet anëtare. Për këtë arsye, Direktiva ka parashikuar vetëm elementet themelore të regjistrimit statistikor të rasteve të kthimit të pasurisë dhe është kufizuar në kategoritë e të dhënave në vijim: (a) sekuestrimi dhe konfiskimi

i pasurisë, (b) gjurmimi i pasurisë, (c) aktiviteti gjyqësor dhe (d) aktivitetet për shitjen e pasurisë. Edhe pse në shikim të parë një listë e tillë mund të duket e thjeshtë dhe që nuk kërkon shumë për t'u zbatuar në kornizat nacionale, një interpretim i hollësishëm tregon që këto kategori të të dhënave e përfshijnë punën dhe rezultatet e të gjitha entiteteve të drejtësisë penale (policisë, prokurorëve, gjykatave dhe agjencive për menaxhimin e pasurisë), që të dhënat e tilla vlejnë për të gjitha fazat e procedurës penale (të fazës së hetimit, të ndjekjes penale dhe të asaj të gjykimit) dhe që ajo madje i përfshin fazat më të hershme të hetimeve penale (hetimet financiare) si kategori e posaçme e të dhënave që kanë të bëjnë me gjurmimin e pasurisë. Prandaj, nuk duhet të jetë befasese që pothuajse pesë vjet pas aprovimit të Direktivës, dispozitat për monitorimin statistikor të rasteve ende nuk janë zbatuar plotësisht në shtetet individuale anëtare të BE-së. Për më tepër, Direktiva kërkon një menaxhim të centralizuar të këtyre statistikave në mënyrë që të komunikojë me Komisionin Evropian nga një pikë e vetme kur i ofron këto informacione. Në anën tjetër, shtetet anëtare duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për t'i mbledhur të dhënat në fjalë, të cilat kanë theks autoritar dhe nuk lejojnë shumë liri në zgjedhjen e kategorive të caktuara të të dhënave të përmendura. Përjashtimet janë në rastet kur arritja e këtyre qëllimeve do të lidhej me një barrë disproporcionale administrative ose kur ka shpenzime të larta për shtetet anëtare në fjalë.

Në veçanti, neni 11 i Direktivës parashikon një grup të standardeve të lidhura me statistikat. Kërkesa e parë që rrjedhë nga kjo dispozitë është që statistikat për kthimin e pasurisë mbahen rregullisht, për rrjedhojë si aktivitet i përhershëm. Kërkesa e dytë për këto statistika është që të jenë gjithëpërfshirëse, do të thotë t'i përmbajnë të gjitha të dhënat relevante, të cilat në anën tjetër shërbejnë për regjistrimin e zbatimit të instrumenteve për kthimin e pasurisë. Veçoritë e të dhënave të tilla janë paraqitur në vijim. Neni 11 po ashtu parashikon ekzistencën e autoriteteve që do të merren me këto çështje ose përmes krijimit të autoriteteve të reja ose përmes fuqizimit të atyre ekzistuese. Statistikat e mbledhura duhet t'i përcillen Komisionit Evropian çdo vit dhe i përfshijnë të dhënat në vijim të përcaktuara në Direktivë:

- a) numrin e urdhrave për sekuestro që janë ekzekutuar;
- b) numrin e urdhrave për konfiskim që janë ekzekutuar;
- c) vlerën e përafërt të pasurisë së sekuestruar, përfshirë pasurinë e sekuestruar duke e pasur parasysh konfiskimin e mundshëm të mëpasëm në kohën e sekuestrimit;
- d) vlerën e përafërt të pasurisë së kthyer në kohën e konfiskimit.

Terminologjia e përdorur në Direktivë tregon që shtetet anëtare janë të obliguara t'i mbledhin këto të dhëna dhe t'ia ofrojnë ato Komisionit. Siç mund të vërehet, ekzistojnë dy elemente kryesore për të cilat këmbëngul Direktiva kur është fjala për përmbajtjet e të dhënave statistikore për kthimin e pasurisë. Këto janë zbatimi i vendimeve të gjykatës për sekuestrimin/konfiskimin e përkohshëm dhe të përhershëm të pasurisë dhe një vlerësim i vlerës së saj. Mbledhja e këtyre të dhënave do të ishte një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit të praktikave të mbledhjes statistikore, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave mbi procedurat gjyqësore, meqë statistikat e mbledhura më parë i kanë përfshirë vetëm të dhënat për vendimet e marra dhe nuk i kanë përfshirë informacionet nëse ato vërtetë janë ekzekutuar ndonjëherë.

Kategoria e dytë përfshin të dhënat, të cilat shtetet anëtare duhet po ashtu t'i dorëzojnë çdo vit në Komisionin Evropian, nëse niveli qendror i shtetit anëtarë në fjalë i ka ato të dhëna. Të dhënat që duhet të mbledhen janë:

- a) numri i kërkesave për urdhra të sekuestros që duhet të ekzekutohen në ndonjë shtet tjetër anëtar;
- b) numri i kërkesave për urdhra të konfiskimit që duhet të ekzekutohen në ndonjë shtet tjetër anëtar;
- c) vlera ose vlera e përafërt e pasurisë së kthyer pas zbatimit në një shtet tjetër anëtar.

Rregullorja 2018/1805, e aprovuar rishtazi, mbi njohjen reciproke të urdhrave për sekuestro dhe të urdhrave për konfiskim po ashtu përmban dispozita lidhur me mbledhjen e të dhënave statistikore. Ato statistika, përveç informacioneve të përmendura në nenin 11 (2) të Direktivës 2014/42/EU, duhet ta përfshijnë numrin e urdhrave për ngrirje dhe të urdhrave për konfiskim, të pranuar nga një shtet anëtar prej shtetit tjetër anëtar që janë njohur dhe ekzekutuar, dhe numrin e atyre që janë refuzuar apo nuk janë ekzekutuar.

Në këtë kategori të të dhënave, fokusi është në ekzekutimin dhe në vlerësimin e pasurive në procedurat e bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare. Duke e pasur parasysh që si Direktiva 2014/42 ashtu edhe Rregullorja 2018/1805 përmbajnë dispozita për statistikat lidhur me kthimin e pasurisë, mund të vihet në përfundim që zbatimi i këtyre instrumenteve është hap i rëndësishëm drejt krijimit të standardeve të BE-së në këtë fushë që do të mund të përdorej po ashtu si standard për juridiksionet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Aktualisht, autoritetet në të gjitha shtetet anëtare të BE-së kanë një lloj regjistri për shpjegimin e pasurisë së konfiskuar. Sidoqoftë, pjesa dërrmuese e regjistrave/bazave të të dhënave nuk e përfshijnë tërë procesin gjyqësor në nivel kombëtar (Universitë degli Studi di Trento, 2018).

Duhet të theksohet që Direktiva 2014/42 përmban vetëm një grup të rregullave dhe të standardeve minimale sipas së cilave duhet të veprojnë shtetet anëtare, që do të thotë se ato kanë të drejtë që në mënyrë të pavarur të ndër marrin masa dhe procedura më të zgjeruara në legjislacionin kombëtar dhe në praktikë. Kjo po ashtu vlen për krijimin e sistemeve të monitorimit statistikor që i matin rezultatet e kthimit të pasurisë.

2. Mekanizmat për regjistrimin statistikor të kthimit të pasurisë në rajon

2.1 Vështrim i përgjithshëm i juridiksioneve

2.1.1 Shqipëria

Nuk ka ndonjë sistem gjithëpërfshirës të mbledhjes së të dhënave për kthimin e pasurisë në Shqipëri. Të dhënat publikohen në raportin vjetor të Prokurorisë për Krime të Rënda, në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme, në raportin vjetor të Gjykatës për Krime të Rënda, në Manualin statistikor të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Drejtorinë e policisë së përgjithshme.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara² nuk posedon një sistem gjithëpërfshirës të mbledhjes së të dhënave. Megjithatë, pas rekomandimeve të MONEYVAL, Ligji i ri për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (ligji nr. 34/2019) ka parashikuar një regjistrë elektronik të të gjitha pasurive të administruar nga Agjencia. Të gjitha institucionet përkatëse mund të kërkojnë të dhëna për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara. Sidoqoftë, Agjencia nuk është e detyruar t'i mbajë të gjitha statistikat në nivel kombëtar, por vetëm për pasuritë nën administrimin e saj³. Ka diskutime të vazhdueshme që sapo të krijohet Zyra për Kthimin e Pasurisë (ZKP),

2 Agjencia ka për detyrë administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara përmes vendimit të gjykatës sipas ligjit nr. 10192/2009, të ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, sipas ligjit 157/2013 dhe administrimin e pasurive të tjera të sekuestruara dhe të konfiskuara të cilat janë produkt i veprave kriminale ose që janë të lidhura me to sipas ligjit, përmes vendimit të gjykatës ose urdhrat të Ministrisë së Financave.

3 Neni 4, Ligji 34/2019 "Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen për:
a) pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara sipas një vendimi të gjykatës kompetente, në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit;

ajo duhet të mbajë një regjistër për kthimin e pasurisë në nivel kombëtar. Të gjitha institucionet do të jenë të detyruara t'i mbledhin dhe t'i dorëzojnë të dhënat statistikore në ZKP.

Aktualisht, vetëm Manuali statistikor i Ministrisë së Drejtësisë ofron informacione lidhur me numrin e plotë të rasteve në gjykata dhe për numrin e plotë të rasteve të përfunduara në gjykata. Burim i të gjitha këtyre të dhënave është Gjykata për Krime të Rënda. Prokuroria për Krime të Rënda dhe Gjykata për Krime të Rënda po ashtu mbajnë shënime lidhur me numrin e plotë të lëndëve në të cilat përfshihet sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë, të cilat të dhëna pastaj përfshihen në Raportet e tyre Vjetore.

Përveç kësaj, informacionet për kategorinë e veprës penale, numrin e vendimeve të gjykatës, pasuritë e sekuestruara ose të konfiskuara, por jo vlera e pasurisë, mbledhen sipas ligjit anti-mafia. Të dhënat dërgohen në Prokurorinë e Përgjithshme për t'u përfshirë në Raportin e Përgjithshëm Vjetor, i cili publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Tabela 1 i tregon të dhënat e ofruara nga Prokuroria për Krime të Rënda, Gjykata për Krime të Rënda, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

2.1.2 Bosnja dhe Hercegovina

Për shkak të strukturës së saj komplekse kushtetuese dhe administrative, Bosnja dhe Hercegovina ka katër sisteme të drejtësisë penale (në nivel shtetëror të B dhe H dhe në nivel të tri entiteteve të Federatës të B dhe H dhe të Republikës Serbe dhe Qarkut të Bërçkos), në kuadër të të cilave ekzistojnë rende të ndryshme të drejtësisë penale dhe të sistemeve gjyqësore. Këto menaxhohen nga një pikë e vetme, përmes rregulluesit qendror, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë (KLGJP). Në kuadër të këtyre katër sistemeve të së drejtës penale, dispozitat për kthimin e pasurisë gjenden në kuadër të fushës së veprimit të ligjit penal dhe të atij të procedurës penale, ndërsa subjektet dhe qarqet kanë po ashtu ligje të posaçme për kthimin e pasurisë. Këto ligje të posaçme i kanë krijuar po ashtu dy agjenci për menaxhimin e pasurisë në Republikën Serbe dhe në Federatën e B dhe H.

Rregullimet institucionale për mbajtjen e statistikave publike përcaktohen në masë të madhe nga struktura administrative e vendit. Kjo nënkupton praktikisht që sistemi statistikor i B dhe H rregullohet përmes disa ligjeve në nivel të shtetit, si edhe në nivel të entitetit, të cilat zbatohen nga agjencia shtetërore për statistika, agjencitë e secilit entitet, si edhe nga banka qendrore, e cila është përgjegjëse për statistikën monetare, bilancin e pagesave dhe statistikën e tjera financiare lidhur me B dhe H (BÇBH). Fushat statistikore të përfshira nga këto tri agjenci statistikore po ashtu përfshijnë fushat e drejtësisë dhe të krimit, ndërsa paralelisht këto statistika administrohen edhe nga KLGJP. Në mënyrë të ngjashme, Agjencitë për Administrimin e Pasurisë kanë kompetenca pak më të ndryshme për mbledhjen e pasurive të sekuestruara përkohësisht dhe përgjithmonë (FBdheH) dhe për të mbajtur dhe përpunuar të dhënat për pasuritë që administrojnë (RS).

Përmes analizimit të mekanizmave lidhur me mënyrën e administrimit dhe të përpunimit të këtyre të dhënave, mund të arrihet në përfundimin që kthimi i pasurisë nuk administrohet në mënyrë të unifikuar, të centralizuar dhe të harmonizuar, do të thotë nuk janë krijuar mekanizma për këmbimin dhe mbledhjen e të dhënave për pasuritë e konfiskuara përkohësisht apo përgjithmonë.

b) pasuritë e konfiskuara dhe të sekuestruara, në pajtueshmëri me dispozitat e ligjislacionit të zbatueshëm për masat kundër financimit të terrorizmit;

c) pasuritë për të cilat shqiptohen masat parandaluese të sekuestrimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, dhe ato që sekuestrohen me anë të një vendimi të gjykatës kompetente, sipas dispozitave të Kodit Penal, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to.”

Kjo mund të provohet praktikisht duke i analizuar publikimet dhe raportet e institucioneve të paraqitura që merren me statistikat në BdheH. Për shembull, agjencia për statistika e BdheH e ka publikuar një raport të titulluar “ Autorët e rritur të veprave penale në Bosnjë dhe Hercegovinë” i cili përfshin vitin 2017. Ky rishikim i përfshin informacionet për autorët e rritur të veprave penale të denoncuar, të akuzuar dhe të dënuar. Këtu përfshihen të dhënat për gjininë e kriminelëve, strukturën e atyre veprave penale dhe rezultatet e procedurës gjyqësore para prokurorëve dhe gjykatave, por raporti nuk e përfshin strukturën dënimeve penale, masat e tjera apo të dhënat për kthimin e pasurisë. Instituti për Statistika i Federatës së BdheH po ashtu e ka publikuar një rishikim të titulluar “Gratë dhe Burrat në Federatën e BdheH “, i cili mbulon vitin 2017, dhe po ashtu e përfshin fushën e administrimit të drejtësisë. Të dhënat nuk janë gjithëpërfshirëse dhe kanë të bëjnë me numrin e autorëve të denoncuar të kategorive të caktuara të krimeve, me numrin dhe gjininë e të punësuarve në institucionet gjyqësore dhe të avokatisë dhe me gjininë e personave të akuzuar dhe të dënuar. Publikimi nuk përmban informacione për kthimin e pasurisë. Në anën tjetër, ky institucion po ashtu e ka publikuar librin vjetor statistikor për vitin 2018, i cili është një dokument shumë më gjithëpërfshirës dhe përmbajtësor që e tregon përbërjen e përgjithshme të të dhënave nga fusha të caktuara. Njëra prej tyre është sistemi gjyqësor dhe të dhënat në këtë kapitull e përfshijnë një numër të gjykatave, gjyqtarëve, prokurorëve, prokurorëve dhe avokatëve. Të dhënat janë marrë nga Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i BdheH, nga Gjykata Kushtetuese e BdheH dhe nga Dhoma e Avokatisë e BdheH. Pjesë kryesore e këtij publikimi është informacioni për autorët e veprave penale dhe për krimet ekonomike dhe mosmarrëveshjet. Tabela 27-4, e cila emërtohet “ Autorët e rritur të veprave penale të ndëshkuar nga dënimet e shqiptuara”, tregon që më 2017, të dënuarit me burgim (7,512 persona) kanë përfshirë 448 persona ndëshkimet e të cilëve përfshinin ndëshkim të mëtejshëm plotësues, 404 prej të cilëve i ishin nënshtruar konfiskimit të pasurisë. Ky është informacioni i vetëm i cili është në dispozicion në këtë rishikim, i cili ka të bëjë me kthimin e pasurisë, dhe e tregon vetëm numrin e personave të dënuar që i ishin nënshtruar konfiskimeve të pasurisë. Në entitetin e Republikës Serbe, instituti përkatës i statistikave i publikon botimet që e përfshijnë një vështrim të përgjithshëm të administrimit të drejtësisë. Ky raport përmban të dhëna që janë dorëzuar përmes prokurorisë dhe gjykatave nga ky entitet në Ministrinë e Drejtësisë të RS dhe përqendrohet në numrin dhe strukturën e institucioneve gjyqësore, në numrin dhe strukturën gjinore të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të punësuar në to dhe së fundi në numrin dhe strukturën e personave të denoncuar, akuzuar dhe dënuar, si të rritur ashtu edhe të mitur. Edhe pse në këtë rishikim ka informacione për përbërjen e të dhënave për të dënuarit, sipas llojit të krimit dhe llojit të sanksionit (burgim, dënim dhe masa plotësuese), aty nuk ka të dhëna për kthimin e pasurisë, edhe pse në raport ka të dhëna për numrin e personave që i janë nënshtruar gjobitjeve. Ekziston po ashtu edhe një publikim i posaçëm i quajtur “Kjo është Republika Serbe”, i cili përmban një pasqyrë të shkurtër të të dhënave për krimet, që përqendrohet në numrin dhe në strukturën e personave të raportuar, të akuzuar dhe të dënuar në institucionet kompetente gjyqësore. Pasqyra nuk përfshin informacione për kthimin e pasurisë.

Agjencitë për Administrimin e Pasurisë në entitetet kombëtare (RS dhe BdheH) po ashtu mbajnë statistika të caktuara në fushën e kthimit të pasurisë. Agjencia e RS mban shënime për pasuritë që administron dhe procedurat gjyqësore në të cilat vendoset për statusin e asaj pasurie. Ajo po ashtu i përpunon dhe i monitoron të dhënat për pasuritë e konfiskuara që vetë i administron, me qëllim të analizës të zbatimit të ligjit. Agjencia në FBdheH mban shënime për pasurinë që e ka në posedim dhe në administrim, si edhe për procedurat gjyqësore në të cilat vendoset për statusin e asaj pasurie. Një detyrim i tillë ligjor nënkupton bashkëpunim të ngushtë dhe lidhje të të dhënave ndërmjet institucioneve gjyqësore dhe të Agjencisë lidhur me rezultatet e procesit në të cilën pasuritë e caktuara janë konfiskuar përkohësisht apo përgjithmonë. Agjencia, në përputhje me këtë ligj, gjithashtu ka kompetenca ligjore për të mbledhur të dhëna, raporte statistikore dhe informacione të tjera nga institucionet kompetente, si edhe nga proceset e përfunduara të kthimit të pasurisë, me qëllim që t'i përpunojë dhe analizojë të dhënat dhe informacionet dhe t'i identifikojë prirjet në veprat penale prej të cilave sigurohen të ardhurat.

Agjencitë për administrimin e pasurisë luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mbledhjen e statistikave për kthimin e pasurisë. Ato janë njëkohësisht burim i rëndësishëm i të dhënave për pasuritë që i shesin dhe i administrojnë, përfshirë edhe vlerën e pasurisë, dhe po ashtu pikë kontakti për integrimin e të dhënave nga rezultati i proceseve gjyqësore në të cilën ishte urdhëruar kthimi i pasurisë. Të dhënat gjyqësore për kthimin e pasurisë mund të kombinohen lehtë me të dhënat e mbajtura nga agjencitë në mënyrë që të rritet besueshmëria e tyre.

Në këtë aspekt, duhet theksuar që KLGJP, si rregullues kryesor i gjyqësorit, e kryen po ashtu edhe funksionin e mbledhjes dhe të përpunimit të statistikave lidhur me punën e gjyqësorit dhe në përputhje me rrethanat udhëheq, bashkërendon dhe e monitoron shfrytëzimin e teknologjisë informative në gjykata dhe në prokurori, në mënyrë që ta arrijë dhe të ruaj njëtrajtshmërinë në gjykata dhe në prokurori në gjithë vendin. Në kuadër të aktiviteteve të tij për monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave statistikore lidhur me rastet në të cilat është regjistruar konfiskimi i të ardhurave nga krimi, në seancën e tij të fundit të mbajtur më 5 dhe 6 shtator 2018, KLGJP e aprovoi "Formularin e regjistrimeve të reja për regjistrimin e të dhënave për kthimin e pasurisë". Ky dokument, së bashku me udhëzimet e tij të veçanta, është dorëzuar në të gjitha prokuroritë e B dhe H. Pastaj nga prokurorët u kërkua që t'i fusin të dhënat në formularë për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2018. Informacionet e ofruara nga KLGJP janë paraqitur në tabelën 2. Informacionet për vitin 2018 për konfiskimin e të ardhurave nga krimi janë publikuar në portalin e KLGJP në internet, pas konkluzioneve të seancës së KLGJP të B dhe H.

Futja dhe mbledhja manuale e të dhënave vazhdoi për vitin 2019, do të thotë deri sa u krijua një modul i specializuar në Sistemin për Menaxhimin e Lëndëve (SML) në gjykata dhe në prokurori. Zhvillimi i këtij = moduli në SML h= është mbështetur nga Bashkimi Evropian përmes fondeve të IPA dhe të Qeverisë Britanike, përmes mbështetjes së ekspertëve për zhvillimin e metodologjisë për mbledhjen e statistikave, përpunimin dhe këmbimin e informacioneve për kthimin e pasurisë. Pritet që të gjitha gjykatat dhe prokuroritë do të fillojnë së shpejti ta përdorin modulën në praktikë, gjë e cila do të përmirësonte në masë të konsiderueshme gjendjen në terren dhe do të zbatonte standardet minimale që rrjedhin nga Direktiva e BE-së e vitit 2014 si edhe nga kërkesat e tjera ndërkombëtare.

2.1.3 Kosova*

Lidhur me statistikat për kthimin e pasurisë në Kosovë*, nuk ekziston ndonjë sistem gjithëpërfshirës i mbledhjes së të dhënave, por ekzistojnë institucione dhe mekanizma që i mbledhin të dhënat statistikore dhe paraqesin raporte gjithëpërfshirëse:

- a) Koordinator kombëtar për luftimin e krimit ekonomik, Këshilli i Prokurorisë së Kosovës*. Roli i tij është promovimi, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi i aktiviteteve të të gjitha institucioneve publike në lidhje me parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen dhe dënimin e të gjitha krimeve që prodhojnë përfitim material në nivel kombëtar. Koordinator kombëtar mbledh të dhëna dhe informacione nga raportet gjithëpërfshirëse të institucioneve përkatëse. Statistikat e mbledhura nga Koordinator Kombëtar përmbajnë të dhëna të siguruar nga Banka Qendrore, NJIF, policia, prokuroritë, gjyqësori, Agjencia Anti-Korrupsion dhe disa agjenci të tjera përkatëse. (Tabela 3)
- b) Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Kjo agjenci është organ i ministrisë së drejtësisë. Të dhënat e siguruar nga agjencia për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar e tregojnë vlerën e pasurive të sekuestruara/të bllokuara (Tabela 3a).

Koordinatori dhe Agjencia nuk i mbledhin të njëjtat të dhëna ndërkohë që Agjencia mban vetëm shënime në lidhje me pasuritë që janë konfiskuar dhe mbahen nga Agjencia, vlera e të cilave mund të bie me kalimin e kohës.

2.1.4 Mali i zi

Institucionet malazeze kompetente për mbledhjen e të dhënave për kthimin e pasurisë janë: Gjykata Supreme, Prokurori i Lartë i Shtetit, Policia, Agjencia e Pronës dhe Zyra e Qeverisë për Integrim Evropian. Publikisht nuk ka në dispozicion të dhëna gjithëpërfshirëse statistikore dhe informacione për kthimin e pasurisë. Zyra e Qeverisë për Integrim Evropian ka mbledhur statistika me qëllim që t'i raportojë Bashkimit Evropian. Këto statistika janë rezultat i harmonizimit dhe konsolidimit të të dhënave nga të gjitha institucionet përkatëse.

Në disa raste janë paraqitur disa të dhëna për kthimin e pasurisë, p.sh. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorisë i kanë prezantuar disa prej këtyre të dhënave gjatë seancës dëgjimore parlamentare dhe kryetari i Gjykatës Supreme dhe Prokurori i Lartë i Shtetit po ashtu i kanë prezantuar disa të dhëna.

Ndonëse raporti statistikor për integrim në BE përfshin të dhëna shumë të dobishme, ai nuk është në dispozicion të publikut.

2.1.5 Maqedonia e Veriut

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përgjegjësia për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore është shpërndarë ndërmjet disa institucioneve. Duke qenë kështu, nuk ka pasur ndonjë metodë të vetme të mbledhjes, të përpunimit dhe të analizimit të të dhënave statistikore lidhur me punën e gjykatave.

Të dhënat statistikore lidhur me punën e gjykatave dhe të gjyqtarëve mbahen nga Gjykata e Lartë e Republikës së Maqedonisë, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Drejtësisë dhe Zyra Shtetërore e Statistikave, për nevojat e tyre. Mungesa e një metodologjie të vetme me instrumente përkatëse metodologjike për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave statistikore ka pasur për pasojë mbledhjen e të dhënave statistikore kontradiktore që nuk mund të krahasohen me të dhënat e tjera të mbledhura dhe të cilat në disa pjesë nuk kanë pasur si rezultat pasqyrën e vetme dhe gjithëpërfshirëse për punën e gjykatave në Republikën e Maqedonisë.

Ministria e Drejtësisë e ka përkufizuar aprovimin e Metodologjisë për Statistikat Gjyqësore si prioritet të lartë në programin kombëtar për aprovimin e Ligjit të Bashkimit Evropian. Dokumentin e parë lidhur me metodologjinë e statistikave gjyqësore e ka hartuar Ministria e Drejtësisë më 2011, në bazë të Udhëzimeve për Statistikat Gjyqësore (USGJ), të aprovuar nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (KEED), në kuadër të Këshillit të Evropës. Ky dokument nuk është botuar kurrë në Gazetën Zyrtare.

Metodologjia do të zbatohet përmes një Sistemi Automatik për Administrimin e Informacionit për Çeshtjet Gjyqësore (SAMILGJ), i cili është plotësisht funksional në Republikën e Maqedonisë së Veriut prej 1 janarit 2010. Përveç kësaj, do të zhvillohet një program software për përpunimin dhe analizimin e të dhënave, i cili do ta mundësojë gjenerimin e tabelave dhe të raporteve analitike për punën e gjykatave. Kjo do ta mundësojë përpunimin dhe analizimin e të dhënave statistikore të mbledhura në bazë të parametrave dhe indikatorëve të parashikuar në metodologji. Programi po ashtu do ta mundësojë ndërveprimin dhe krahasimin e të gjitha llojeve të të dhënave statistikore për përmbushjen e gjykatave. Zgjidhjet e ofruara në aplikacion dhe harmonizimi me metodologjinë dhe me rregullimin ligjor në Republikën e Maqedonisë do të aprovohet nga një komision i përbërë nga përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Drejtësisë, Zyra Shtetërore e Statistikave, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, Gjykatat e Apelit, Gjykata e Lartë Administrative, Gjykata Administrative, Gjykata

Themelore I e Shkupit, Gjykata Themelore II e Shkupit dhe gjykatat themelore me kompetenca të zgjeruara dhe themelore. Programi software ende nuk është përfunduar.

Të dhënat statistikore për vitin 2017 dhe 2018 të pranuar nga Ministria e Drejtësisë janë paraqitur në tabelën 5.

2.1.6 Serbia

Të dhënat statistikore për masat e përkohshme dhe të përhershme të sekuestrimit dhe të konfiskimit mbledhen dhe analizohen nga prokurorët, gjykatat dhe Drejtoria për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar (Ministria e Drejtësisë). Drejtoria ka për detyrë të mbajë shënime për pasurinë që e administron dhe për seancat gjyqësore në të cilat vendoset për konfiskimin e pasurisë që është rezultat i veprës penale. Drejtoria kryen mbledhje dhe analizim individual të këtyre të dhënave. Në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Serbisë në rastet e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, gjykatat dhe prokurorët kanë për detyrë të mbledhin të dhëna të veçanta për ato raste, në të cilat përfshihen edhe të dhënat për sekuestrimin e pasurisë.

Të gjitha institucionet e përmendura më sipër mbajnë të dhëna të posaçme për masat e përkohshme dhe të përhershme të sekuestrimit dhe të konfiskimit. Në Manualin e Gjykatës, i cili parashikon futjen e të gjitha të dhënave në një sistem elektronik, ekziston një pjesë e posaçme për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë. Megjithatë, ky sistem nuk e lejon ngarkimin e të dhënave lidhur me llojin e pasurisë dhe vlerën e saj. Së fundi, Drejtoria për Administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar ka filluar me aplikimin e një sistemi të ri të software, i cili do ta mundësojë ngarkimin e këtyre të dhënave në sistem. Të gjitha të dhënat përkatëse të mbledhura nga gjykatat pastaj do të përpunohen me softuerin e ri. Të dhënat e fituara do të jenë në dispozicion të të gjitha institucioneve përkatëse dhe Drejtoria do t'i ngarkojë të gjitha të dhënat e mbledhura prej vitit 2010.

Të dhënat e mbledhura nga gjykatat mbledhen veçmas nga të dhënat për rastet penale. Kjo nënkupton që gjykatat mbajnë shënime veçmas për rastet e sekuestrimit të pasurisë duke e krijuar një rast të ri në shënimet e tyre për këto të dhëna pas marrjes së një kërkesë për sekuestro apo konfiskim nga ana e prokurorit.

Sipas Manualit të Gjykatës, gjykatat duhet t'i regjistrojnë të dhënat si për pasurinë e sekuestruar ashtu edhe për atë të konfiskuar përkohësisht, në të cilat të dhëna përfshihen informacionet në vijim:

- Numri i lëndës
- Numri dhe data e veprimit të parë të prokurorit
- Numri i veprës penale bazë
- Emri i autorit të veprës penale, personit të tretë
- Lloji i veprës penale
- Datat e gjykimeve
- Lloji i vendimit gjyqësor (urdhri për sekuestro apo konfiskim)
- Data e vendimit gjyqësor
- Kohëzgjatja e procesit gjyqësor
- Emri i pronarit të pasurisë dhe të gjitha të dhënat përkatëse për personin fizik apo juridik
- Të dhënat për llojin dhe vlerën e pasurisë (ende nuk janë në dispozicion)
- Data e pranimit të padive dhe ankesave kundër vendimeve gjyqësore
- Data dhe lloji i vendimeve të gjykatave të larta
- Data e vendimeve ligjrisht të detyrueshme – data e vlefshmërisë
- Data për dorëzimin e vendimeve gjyqësore në Drejtorinë për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara

Të gjitha të dhënat mbahen rregullisht dhe publikohen në raportet periodike të gjykatës.

Përveç kësaj, prej vitit 2010 prokurorët nga të gjitha shkallët i mbajnë shënimet e tyre në një formular të posaçëm, i cili i dorëzohet Prokurorisë së Republikës. Prokuroria e Republikës mban shënimet për të dhënat në nivel kombëtar. Këto të dhëna sistematizohen dhe analizohen çdo tre muaj.

Aktualisht, vetëm 14 prokurori e posedojnë sistemin e ashtuquajtur SAP për mbledhjen e të dhënave. Në këtë grup bëjnë pjesë: Prokuroria për Krim të Organizuar, Prokurori i Lartë në Beograd (që po ashtu merret me rastet e larta të korrupsionit) dhe Prokuroritë e Apelit në Beograd dhe në Nish. Prokuroritë e tjera mbledhin të dhëna në mënyrë manuale dhe kjo gjë nuk shkakton probleme të mëdha meqë numri i rasteve me të cilat merren ato është më i ulët krahasuar me ato të përmendura më sipër.

Këto të dhëna mund të merren nga raportet vjetore të gjykatave dhe të prokurorëve.

Si përfundim, sistemi serb për mbledhjen e të dhënave është i mirë dhe e mundëson zhvillimin e analizimit të shkëlqyeshëm të të dhënave për kthimin e pasurisë.

Megjithatë problem mbeten sistemet e software të përdorura nga gjyqësori, të cilat nuk e mundësojnë ngarkimin e të gjitha të dhënave përkatëse. Sidoqoftë, nëse ka nevojë, sidomos lidhur me llojin dhe vlerën e pasurisë, të dhënat që mungojnë mund të mblidhen duke e rishikuar secilin rast gjyqësor.

Më tej, Drejtoria për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara e ka siguruar një sistem të ri software, i cili është në përdorim tashmë prej shtatorit 2019. Aktualisht është duke u bërë ngarkimi i të dhënave në sistemin e ri, i cili do të shërbejë si magazinë për të gjitha të dhënat përkatëse.

Të gjitha të dhënat e mbledhura për Serbinë janë paraqitur në tabelën 6.

3. Standardet drejt krijimit të mekanizmave të përshtatshëm statistikor për kthimin e pasurisë në rajon

STANDARDET		
Standard	Sqarim	Prioritet
Gjithëpërfshirës	<p>Statistikat për kthimin e pasurisë duhet të përfshijnë një spektër të gjerë të kategorive të cilat u referohen të gjitha fazat e procedurës së kthimit: (1) hetimet financiare (gjurmimi, identifikimi, lokalizimi etj.), (2) masat e përkohshme (ngrirja dhe/ose sekuestrimi), (3) vendimet gjyqësore të formës së prerë për të gjitha llojet e procedurave (konfiskimi i zakonshëm, konfiskimi i zgjeruar, konfiskimi parandalues, konfiskimi i vlerës, konfiskimi pa dënim penal, kthimi civil, etj.), (4) ekzekutimi i urdhrave gjyqësor për ngrirje dhe/ose sekuestrim të përkohshëm dhe konfiskim përfundimtar, përfshirë ekzekutimin me forcë të urdhrave gjyqësorë, (5) shitja e pasurisë.</p>	Top
I qëndrueshem	<p>Të dhënat për kthimin e pasurisë duhet të mblidhen në mënyrë sistematike, vazhdimisht, me artikujt e njëjtë në të gjitha burimet e të dhënave (gjyqësor, ligj zbatuese, administrim të pasurisë etj.). Është me rëndësi që metodologjia për mbledhjen, regjistrimin dhe analizimin e të dhënave të jetë e ngjashme me ato që përdoren në të dhënat zyrtare për krimin dhe duhet t'i përcjellë shifrat e krimin, pa dyfishim dhe dykuptimësi.</p> <p>Një shembull i mirë i përfshin të dhënat të qëndrueshme për numrin e çështjes (si letërnjoftim unik i cili shërben si shenjë për përcjellje), veprat prej të cilave është kthyer pasuria, shumën/vlerën e pasurisë, llojin dhe numrin e pasurisë etj.).</p> <p>Për shembull, nëse në një rast ka përfunduar procesi penal kundër një grupi të krimin të organizuar dhe për tre prej pesë të dënuarve është vendosur konfiskimi, një automjet është konfiskuar nga njëri, paratë e gatshme prej tjetrit, shumën (e barasvlerëshme) e të ardhurave të fituara nga tjetri, atëherë në statistikën e gjykatës duhet të shënohet si një rast i përfunduar i krimin të organizuar, në statistikën e instituteve pesë persona të dënuar për krim të organizuar, tre prej të cilëve ju është vendosur masa e konfiskimit, ndërsa agjencia për administrimin e pasurive do ta regjistrojë çfarë ka bërë me automjetin dhe paratë që i janë besuar për ruajtje. Informacionet e përmbledhura duhet po ashtu të përfshijnë vlerën e plotë të të gjithë pasurisë së konfiskuar.</p>	Top
Krahasues	<p>Nëse të dhënat regjistrohen dhe mblidhen në mënyrë të qëndrueshme, duhet të ekzistojë mundësia që ato të përdoren për krahasim, si në nivel të vendit ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Këto standarde sigurojnë shkëmbim të mirë të të dhënave ndërmjet agjencive të përfshira në zbatimin e ligjeve për kthimin e pasurisë, si edhe shkëmbim ndërkombëtar të të dhënave të tilla, harmonizim të përpjekjeve strategjike dhe bashkëpunim më të mirë ndërkufitar.</p>	Middle
Diskriminues	<p>Ky standard përfshin kërkesën për mbajtjen e shënimeve për kthim të pasurisë për së paku dy kategori kryesore: pasurinë e sekuestruar përkohësisht dhe përgjithmonë dhe pasuritë e konfiskuara. Ndryshime të caktuara mund të vihen re brenda këtyre dy kategorive. Për shembull, masat e përkohshme ndaj një prone të caktuar (si manifestim i të ardhurave nga krimi) ndoshta do të mund ta përfshinin urdhrin për sekuestro të lëshuar nga gjykata (urdhër ngrirje për kalimin e pronësisë në regjistrin zyrtar të cilin e mban policia) dhe njëkohësisht sekuestrimin e automjetit me qëllim që t'ia dorëzojë një agjencie për administrimin e pasurisë. Në rastet e tjera do të bëhej vetëm ngrirja pa sekuestrim, meqë gjykata ka vendosur ta lërë pasurinë nën kontrollin e pronarit, pa ndonjë mundësi të shitjes, dhënies me qira ose dhurimit të automjetit palëve të treta. Statistikat zyrtare duhet ta regjistrojnë këtë dhe të jenë në gjendje që pastaj ta gjurmojnë fatin e pasurisë së bllokuar dhe/ose të sekuestruar përkohësisht (që është njëra prej standardeve kryesore të Direktivës së BE-së të vitit 2014).</p>	Top

<p>I bazuar në rezultate</p>	<p>Si standard i zhvilluar rishtas dhe kompleks përfshin një kërkesë që ta vërtetojë në mënyrë të besueshme gjendjen e vërtetë të pasurive që u nënshtrohen masave për kthimin e pasurisë. Prandaj gjendja e pronës së përfshirë është çështja më e rëndësishme dhe statistikat zyrtare duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë çka është kthyer në të vërtetë në secilin rast individual. Me sa duket përqendrimi është në ekzekutimin e vendimeve të gjykatës për ngrirjen dhe/ose sekuestrimin e përkohshëm si edhe të konfiskimit të përhershëm të pasurisë. Duke e pasur parasysh që juridiksionet e ndryshme kanë regjime të llojllojshme ligjore në të cilat mund të merret prona si e ardhur nga krimi, kjo nënkupton nevojën e përfshirjes së të gjithë atyre skenarëve në metodologjinë statistikore.</p> <p>Kjo është në lidhje të ngushtë me të dhënat statistikore të mbajtura nga agjencitë për administrimin e pasurisë, meqë destinacioni përfundimtar i pronës së përfshirë do të varet nga një vendim i marrë nga agjencia, i cili është modaliteti më i mirë i administrimit të pasurisë.</p> <p>Në këtë rast, të dhënat statistikore do të jenë në gjendje të tregojnë nëse e kanë parashikuar shitjen, huazimin, dhënien me qira ose shkatërrimin e pronës së zgjedhur për sekuestrim të përkohshëm. Po ashtu do të jetë e mundur të identifikohet destinacioni i fundit i parave të gatshme të sekuestruara meqë mund të mbahen në një kasafortë apo të deponohen në një llogari të caktuar për qëllime të këtylla. Nëse është kthyer pasuria ose është përdorur për kompensim të viktimave, atëherë edhe kjo duhet të theksohet qartë.</p> <p>Pasuritë e konfiskuara përgjithmonë mund të përdoren sërisht për qëllime shoqërore dhe statistikat duhet të përmbajnë informacionet e tilla, ose ato mund të shiten dhe të ardhurat të përdoren për disa qëllime të tjera (p.sh. për financimin e rindërtimit të spitaleve për fëmijë ose të stacioneve policore). Prandaj, agjencitë për administrimin e pasurisë, si edhe gjykatat, duhet t'i mbajnë statistikat, të cilat mund të sigurojnë ekzistencën e informacioneve të vërteta, të sakta dhe të besueshme në çdo çast. Njëra prej përfitimeve nga një metodologji e tillë është vlerësimi i prioriteteve dhe i shpjegimit të arsyeshëm të gjyqësorit dhe të institucioneve të tjera të përfshira kur i zbatojnë dispozitat për kthimin e pasurisë. Nëse pjesa dërrmuese e pasurisë në të vërtetë kthehet si e ardhur në buxhet, atëherë kjo mund të perceptohet si mënyrë e të menduarit ekonomik, kundër një skenari sipas të cilit institucionet kompetente përpiqen të kompensojnë viktimat e krimit ose të mbështesin programet për parandalimin e krimit, të rrisin kapacitetet e zbatimit të ligjit dhe mekanizmat shoqëror kundër krimit në përgjithësi. Qasja e fundit është më shumë e orientuar drejt legjitimitetit të sistemit në përgjithësi, rritjes së besimit në institucione dhe drejtësisë në shoqëri.</p>	<p>Top</p>
<p>I centralizuar</p>	<p>Është fakt që në secilin juridiksion një numër i institucioneve i mbledhin, i ruajnë dhe i përpunojnë statistikat për kthimin e pasurisë. Në thelb, secili institucion në zinxhirin e zbatimit të ligjit, prej policisë, përmes prokurorive dhe gjykatave, deri tek agjencitë për administrimin e pasurisë, mban shënime çfarë ka bërë në secilin rast të caktuar. Institutet statistikore, ministritë e drejtësisë dhe rregulluesit e gjyqësorit, disa instanca të larta gjyqësore dhe të prokurorisë, dhe të tjerët që i mbajnë këto informacione, e respektojnë këtë rregull. Do të ishte jashtëzakonisht e rëndësishme nëse autoriteti qendror do ta aprovonte një bazë të strukturuar të të dhënave, të cilës të gjitha institucionet përkatëse ia dërgojnë të dhënat e tyre, në pajtueshmëri me një metodologji të dakorduar paraprakisht, dhe e mbajnë një qasje konsekuente, në mënyrë që të dhënat të mund të grumbulloheshin dhe të përdoshin.</p> <p>Megjithatë, përveç kërkesës për administrim të qëndrueshëm të këtyre të dhënave, një standard i posaçëm kërkon që duhet të ekzistojë një pikë e vetme kontakti brenda një institucioni ekzistues që do të ishte përgjegjëse për komunikimin me subjektet mbi kombëtare dhe ato ndërkombëtare para tërë vendit/juridiksionit (Komisioni Evropian, KB, Këshilli i Evropës, etj.) me qëllim që t'i dorëzojë statistikat e plota të kthimit të pasurisë.</p>	<p>Middle</p>
<p>I specializuar</p>	<p>Për ta krijuar një mekanizëm kompleks dhe të vështirë për monitorimin e çështjeve në të cilat është urdhëruar kthimi i pasurisë, nevojitet një nivel i lartë i edukimit dhe i trajnimit për ata që i shfrytëzojnë këto instrumente të avancuara. Në mënyrë që të sigurohet një qasje e barabartë në shfrytëzimin e këtyre procedurave të reja metodologjike, është e nevojshëm të sigurohet zhvillimi i broshurave, udhëzimeve dhe manualeve të përshtatshëm dhe ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm për të gjithë profesionistët të cilët punojnë drejtpërdrejt në plotësimin e formularëve statistikorë në bazë të të cilëve paraqiten raportet, analizat dhe botimet e konsoliduara.</p>	<p>Middle</p>

<p style="text-align: center;">I ndërveprueshëm</p>	<p>Sapo të vendosen mekanizmat e njëtrajtshëm dhe gjithëpërfshirës për monitorimin statistikor të rasteve të kthimit të pasurisë dhe sapo të përfundojë edukimi dhe trajnimi i plotë i përdoruesve, do të jetë e mundur të mendohet për ndërveprueshmërinë e mekanizmave të reja. Shtrirja e mjedisit institucional tek një numër i madh i shfrytëzuesve, përfshirë kategoritë e reja të të dhënave nga regjistrat e institucioneve të tjera (p.sh. bankat, regjistrat e patundshmërive, shtëpitë e ankandit, etj.) paraqitja, analizimi dhe shpërndarja e kategorive të specializuara të të dhënave dhe publikimeve do të rrishte konsiderueshëm mundësitë për zbatimin e tyre praktik, në veçanti në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e politikave të reja dhe qasjeve strategjike.</p>	<p style="text-align: center;">Low</p>
<p style="text-align: center;">Digjital</p>	<p>Digjitalizimi i të dhënave zyrtare sjellë një numër të përparësive dhe deri më tani është bërë shumë në këtë aspekt. Në veçanti, një sistem i administrimit automatik të çështjeve është futur në përdorim në gjyqësor, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e punës është kryer në lidhje me krijimin e bazës elektronike të të dhënave në polici dhe pjesërisht në agjencitë për administrimin e pasurisë. Është vendimtare të bëhet përmirësimi i bazave ekzistuese të të dhënave me njësi (module) speciale që do ta mbulonin ekskluzivisht fushën e kthimit të pasurisë, të cilat do të përfshinin të gjitha standardet e mësipërme në mënyrë që të sigurohet një mjet efikas për përpunimin dhe qasjen e shpejtë në të dhëna, duke ofruar siguri për të dhënat dhe përparësitë e tjera të shërbimeve digjitale.</p>	<p style="text-align: center;">Middle</p>
<p style="text-align: center;">Publik</p>	<p>Publiku është shumë i interesuar për të zbuluar sa efektive janë masat për kthimin e pasurisë në praktikë dhe cili është ndikimi i vërtetë i ligjeve të aprovuara. Mënyra më e mirë për ta realizuar pritshmërinë dhe nevojat e publikut është që një numër i konsiderueshëm i statistikave të vihet në dispozicion të tyre. Kjo mund të bëhet përmes faqeve të internetit të institucioneve kompetente, përmes njoftimeve të rregullta dhe mjeteve të tjera (d.m.th. dorëzimit të kërkesës). Përveç kësaj, kjo e forcon besimin në institucione, legjitimitetin dhe i jep shtysë angazhimit të mëtejshëm drejt një zbatimi më të fuqishëm të ligjeve për kthimin e pasurisë. Kjo mund të mbështetet edhe përmes publikimeve periodike të shembujve të mirë (rasteve) të kthimit të pasurisë, posaçërisht nëse iu referohen rasteve të profilit të lartë dhe shumave (vlerave) të mëdha të pasurive të konfiskuara, dhe të një rezultati të dukshëm për përdorimin e pasurive për qëllime të gjera shoqërore.</p>	<p style="text-align: center;">Middle</p>

4. Baza për mbledhjen e të dhënave statistikore

Viti	XXXX	XXXX
Numri i plotë i çështjeve në gjykata		
Numri i plotë i çështjeve të përfunduara në gjykata		
Numri i plotë i çështjeve në të cilat pasuria është ruajtur përkohësisht		
Numri i urdhrave të sekuestros të ekzekutuar		
Vlera e përafërt e pronës së sekuestruar		
Vlera e përafërt e pronës së sekuestruar me qëllimin e konfiskimit të mëvonshëm në kohën e sekuestrimit		
Numri i plotë i çështjeve në të cilat pasuria është kthyer përgjithmonë		
The number of confiscation orders executed		
Vlera e përafërt e pasurisë së kthyer në kohën e konfiskimit		

	Numri i çështjes		
INFORMACIONE PËR VEPRËN PENALE	Titulli		
	Neni (Kodi Penal ose tjetër)		
	Koha kur është kryer vepra penale		
INFORMACIONE PËR PROCEDURËN	Data kur ka filluar procedura		
	Data e vlefshmërisë		
INFORMACIONE PËR AUTORIN(T) E VEPRËS PENALE	Subjekti ligjor		
	Subjekti fizik	Gjinia	
		Mosha	
		Edukimi	
Dënimet e mëparshme			
INFORMACIONE PËR HETIMIN FINANCIARE (NËSE ËSHTË KRYER)	Data kur ka filluar hetimi		
	Data kur ka përfunduar hetimi		

PJESA II – HISTORITË E SUKSESSHME

1. Rast studimi për Shqipërinë – Konfiskimi nga pala e tretë

Ky rast studimi ka të bëjë me zbatimin e Ligjit nr.10192, të datës 03.12.2009, “Mbi parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me Ligjin nr.70/2017, i njohur si “Ligji anti-mafia”, si ligji me fuqinë në luftën kundër krimit të organizuar lidhur me pasurinë.

Hetimet pasuror kishte nisur nga Prokuroria për Krime të Rënda mbi referimin e bërë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor të Vlorës. Ky referim kishte të bënte me procedimin penal për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprave penale”, sipas nenit 287 të Kodit Penal, në emër të shtetasit të njohur si E.B.

Hetimet kryera nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor të Vlorës zbuluan që shtetasi S. B., i ati i shtetasve I. K. (i vdekur) dhe E. B., kishte marrë leje të legalizimit lidhur me një ndërtesë me sipërfaqe ndërtimore prej 2500 m², një sipërfaqe e plotë prej 3199 m², dhe pesë kate. Ndërtesa kishte një vlerë të konsiderueshme monetare.

Për shkak të faktit që shtetasit I.K. (i vdekur) dhe E. B. kishin qenë nën hetime për trafikim të drogës, ata ishin nënshtruar subjekt të ligjit parandalues, të njohur si ligji anti-mafia, të cilit i nënshtroheshin pasuritë e tyre.

Pas hetimeve paraprake, Prokuroria për Krime të Rënda zbuloi që një pasuri me vlerë të konsiderueshme ishte regjistruar në emër të shtetasit S. B. (i ati). Kjo pasuri ishte në shpërpjesëtim me të ardhurat e tij, meqë ai nuk merrej me ndonjë aktivitet të ligjshëm fitimprurës. Prokuroria, në mënyrë që ta mbrojë pasurinë nga bartja tek një palë e tretë, kërkoi nga Gjykata për Krime të Rënda sekuestrimin e saj.

Gjykata për Krime të Rënda, e cila ishte gjykata e vetme kompetente për zbatimin e ligjit anti-mafia dhe hetimet e pasurisë lidhur me të, e pranoi këtë kërkesë dhe vendosi masën parandaluese për sekuestrimin e pasurisë së S.B., duke vëndosur sekuestrimin e pasurisë së përmendur më lart.

Kërkesa u shqyrtua në prani të prokurorit dhe të akteve të mbledhura gjatë hetimit të Prokurorisë për Krime të Rënda dhe të policisë gjyqësore.

Shtetasi S.B. pasi u njoh me vendimin e sekuestrimit e kundërshtoi atë duke ankimuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të Rënda. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda la në fuqi vendimin për sekuestrimin e pasurisë me arsyetimin që kjo është një masë paraprake dhe bëhet për të garantuar ngrirjen e një pasurie që dyshohet të jetë fituar nga aktiviteti kriminal, në veçanti nga trafikimi i lëndëve narkotike në shtetet e BE-së nga ana e shtetasve shqiptar I.K. (i vdekur) dhe E. B.

Pas sekuestrimit të pasurisë, Prokuroria për Krime të Rënda zhvilloi hetime të thelluara lidhur me pasurinë duke mbledhur të gjithë dokumentacionin penal dhe të pasurisë të personave nën hetim, I. K. (i vdekur) dhe E. B., dhe të personit të lidhur me ta, të atit të tyre S. B., në emër të të cilit ishte regjistruar pasuria.

Pas përfundimit të hetimeve lidhur me procedimin penal të lidhur me të, Prokuroria dorëzoi në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në Tiranë një kërkesë për konfiskimin e pasurisë

së regjistruar në emër të S. B.

Në gjykimin e shkallës së parë, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit pretendoi që S. B. kishte marrë hua të konsiderueshme nga palët e treta, të ardhura që ishin shfrytëzuar për ndërtimin e ndërtesës që ishte objekt i konfiskimit. Shtetasit A.M, A.G, H. M. dhe B. M. u thirrën në gjykim në cilësinë e palëve të treta.

Në përfundim të gjykit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda vendosi ta pranojë kërkesën e Prokurorisë të dorëzuar në Gjykatën për Krime të Rënda të Tiranës, duke konfiskuar pasurinë e paluajtshme të S.B.-së dhe duke e kaluar në pronësi të shtetit.

Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në Tiranë është ushtruar e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Pas marrjes në shqyrtim të ankimit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda vendosi ta kthejë çështjen për rigjykim me tjetër trup gjykues në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për shkak të mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë.

Në rigjykim, Prokuroria për Krime të Rënda si palë paditëse pretendoi se referuar akteve të administruara nga autoritetet italiane të drejtësisë evidentohet ekzistenca e proceseve penale dhe të zhvillimit të seancave gjyqësore kundër shtetasve E.B. dhe I.K. (i vdekur) në lidhje me veprat penale të “Mbajtjes dhe transportimit të lëndëve narkotike” në bashkëpunim, dhe “Pjesëmarrjes në organizata ndërkombëtare për trafikimin e lëndëve narkotike, mbajtjes dhe transportimit të lëndëve narkotike”, në bashkëpunim.

E gjithë pasuria objekt konfiskimi dyshohej që ishte fituar nga të ardhurat e realizuara si rezultat i aktivitetit kriminal të kryer jashtë shtetit nga personi i hetuar E. B. dhe vëllai i tij I.K. (i vdekur), të dy djem të S.B.

Në lidhje me pasuritë e sekuestruara, prokurori pretendoi që, në sipas neneve 22 dhe 24 të Ligjit nr. 10192 të datës 03.12.2009 “Mbi parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit përmes masave parandaluese kundër pasurisë”, ekzistojnë kushtet për konfiskimin e tyre. Këto kushte janë që së pari ato ishin përfituar pas përfshirjes së personave të hetuar E.B. dhe vëllait të tij I. K. (i vdekur) në veprimtari kriminale. Së dyti, këto pasuri nuk i përgjigjen nivelit të të ardhurave të të dyshuarve dhe familjarëve të tyre. Së treti, pasuritë ishte në posedim të drejtpërdrejtë të personave të hetuar. Përkundër faktit që dokumentet ishin të regjistruara në emrin e babait të tyre, në deklaratat e këtij të fundit thuhej që objekti i ndërtuar ishte fryt i investimeve të djemve të tij E.B. dhe I.K. (i vdekur).

Përfaqësuesi i palës të paditur pretendoi që objekti ishte ndërtuar nga të ardhurat e fituara nga anëtarët e familjes së S.B.-së në Shqipëri dhe nga anëtarët e tjerë të familjes që jetonin në Itali për shumë vite. Kjo pronë është e regjistruar në emër të të paditurit S.B. vetëm për arsye se ai ishte kryefamiljar dhe për të ruajtur unitetin dhe harmoninë familjare. Një pjesë e madhe e ndërtimit ishte realizuar përmes huave të marra nga subjektet e tjera që ishin ftuar në gjykim si persona të tretë. Anëtarët e familjes, si shtetasit B.B., G.B., A. B., L.B., pretenduan që kishin punuar në Itali dhe në këtë mënyrë kishin realizuar të ardhura të konsiderueshme.

Përveç provave shkresore dhe me dëshmitarë që ishin kërkuar nga palët ndërgjyqëse, gjykata caktoi dhe ekspertë për vlerësimin e pasurisë.

Gjithashtu, Gjykata caktoi një ekspert kontabël për të llogaritur të ardhurat e ligjshme të shtetasit S.B. dhe të familjarëve të tij dhe diferencën e mbetur mes tyre dhe shpenzimeve të kryera. Sipas ekspertëve financiarë, kishte mungesë të likuiditetit në shumën prej 17, 818, 531 lekë.

Pas shqyrtimit të provave, gjykata e pranoi kërkesën për konfiskim pasi u vërtetua gjyqësisht se pasuria në emër të shtetasit S.B. nuk ishte fituar me të ardhurat e tij të ligjshme, por ishte rezultat i investimit të parave të fituara me veprimtari kriminale nga djemtë e tij.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në Tiranë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

2. Rast studimi për Bosnjën dhe Hercegovinën – Hetim financiar dhe bashkëpunim ndërkombëtar

a. Përshkrimi i rastit

Ky rast u paraqit në Gjykatën Kantonale në Sarajevë, prej vitit 2016 deri në mes të vitit 2019, kundër tre personave të akuzuar; dy meshkujve të moshës 47 vjeçare dhe një femre të moshës 38 vjeçare. Prokuroria Kantonale e Kantonit të Sarajevës ngriti akuza kundër tyre për pjesëmarrje në krim të organizuar, shmangie nga pagesa e tatimit dhe pastrim të parave.

Vendimi i shkallës së parë u mor në korrik 2018, por pas ankesave të palëve në procedurë, Gjykata Supreme e Federatës së BdheH e revokoi atë vendim dhe urdhëroi të bëhej rigjykimi i çështjes.

Pas rigjykimit, gjykata nxori përsëri një dënim, duke i shpallur të pandehurit fajtorë, i dënoi me trembëdhjetë vjet burgim (të pandehurin e parë dhe të dytë) dhe me tre vjet burgim të pandehurin e tretë. Përveç nënshtetësisë së BdheH, i pandehuri i parë dhe i dytë kanë edhe nënshtetësi të Federatës Ruse.

Aktualisht çështja është në apel në Gjykatën Supreme të Federatës së BdheH dhe kjo analizë nuk e paraqyt përgjegjësinë e ndonjëres prej palëve dhe nuk e kundërshton prezumimin e pafajësisë së personave të përfshirë, por vetëm merret me çështje ligjore lidhur me kthimin e pasurisë.

b. Karakteristikat kryesore të hetimit financiar

Hetimet në këtë çështje i ka drejtuar Prokurori Kantonal i Sarajevës, i cili i ka bashkërenduar veprimet hetimore të kryesuara nga departamenti kompetent i SIPA, i cili funksionon i koordinuar me NJIF-in kombëtar. Informacionet e para ishin marrë nga NJIF-i kombëtar më 2012 nga një bankë tregtare, e cila, në bazë të sistemit të tyre monitorues për transaksionet monetare dhe të kategorizimit të rrezikut për klientët individualë, në pajtueshmëri me detyrimet e bankave sipas Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të veprimtarive terroriste të BdheH, raportoi transaksionet e parave në llogaritë bankare të të pandehurve, pas së cilës SIPA, si NJIF kombëtar i filloi veprimet hetimore në këtë rast.

Arsyeja specifike pse banka tregtare e krijoi një STR (raport për transaksione të dyshimta) ishte prania e një numri të treguesve të veprimtarive të dyshimta, në veçanti gjatë një periudhe të shkurtër kohore pas hapjes së llogarive të shtetasve rezidentë në BdheH. Në këtë periudhë filloi një derdhje e shumave të mëdha të transaksioneve të valutave të huaja, në veçanti nga Emiratet e Bashkuara Arabe, të pasuara nga transaksionet bazike për pagesat e përshkruara si “pagesa për shërbime”, së bashku me dokumentacionin tregtar që i shoqëronte këto transaksione të parave (marrëveshje të mirëkuptimit), etj.

Më pas u bë monitorimi aktiv i llogarive të dyshimta bankare të cilat gjendeshin në disa banka tregtare, i cili zgjati disa muaj. Ndërsa gjurmonte shpenzimet nga llogaritë e dyshimta, NJIF zbuloi që

paratë në ato llogari nuk shfrytëzoheshin për qëllime biznesi në BdheH, por për nevoja personale, domethënë për blerjen e pronave të paluajtshme, fondeve të vlerës së mbetur (ekuitetit), automjetet dhe artikujt e tjerë.

Përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, NJIF identifikoi lëvizjet e të dyshuarve në disa shtete, përfshirë EBA, Rusinë, etj., dhe përmes kontrolleve të Interpolit zbuloi se në këto shtete, kompanitë që ishin identifikuar se kanë bërë pagesa në BdheH nuk kishin ndonjë aktivitet biznesi në ato shtete dhe, në thelb, ishin të rreme.

Në llogaritë e mbikëqyrura bankare u zbulua hyrja e mbi 20 milionë KM në përgjithësi, ndërsa në bashkëpunim me Administratën Tatimore u vendos që të gjitha transaksionet financiare që zhvilloheshin në llogari dhe prej saj përmbanin elemente që ngrinin dyshime për shmangie nga tatimi.

Me rëndësi vendimtare për rastin ishte që një person i përfshirë u karakterizua si person i ekspozuar politikisht (PEP), një tregues i rëndësishëm sa i përket zbulimit të transaksioneve të dyshimta lidhur me pastrimin e parave.

Po ashtu është interesant që hetimi financiar zbuloi që një numër i transaksioneve financiare në disa shtete, përfshirë Gjermaninë, ishin të lidhura me një rrjet të transaksioneve që në fund përfundonin në llogaritë bankare të të akuzuarve në BdheH. Importimi i mallrave (automjeteve të blinduara), shërbimet e marketingut, etj., përmendeshin si arsye zyrtare dhe bazë për realizimin e këtyre transaksioneve.

c. Çështjet përkatëse ligjore me rëndësi për kthimin e pasurisë

Në këtë rast janë identifikuar disa çështje kryesore ligjore që duhet të përmenden në mënyrë që të kuptohet dhe të vlerësohet si duhet suksesi i tërë procesit penal dhe konfiskimi i pasurisë së caktuar kriminale.

Së pari duhet të përmendet që njëra prej sfidave kryesore në këtë rast lidhet me zbatimin e buri-meve ndërkombëtare ligjore (në veçanti konventave) të cilat i ka miratuar Bosnja dhe Hercegovina dhe të cilat është e detyruar t'i zbatojë në rendin e saj juridik. Në mënyrë specifike, gjykata në këtë rast ka zbatuar Konventën e Këshillit të Evropës (CETS nr.198) "Mbi Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe Financimin e Terrorizmit", të cilën Bosnja dhe Hercegovina e ka ratifikuar më 2013 dhe që është në fuqi prej datës 1 Qershor 2013. Në atë kohë jurisprudenca e gjykatave lidhur me zbatimin e drejtpërdrejtë të instrumenteve ndërkombëtare penale ndryshonte dhe zbatohet rast pas rasti. Do të jetë interesant të shihet si do të vendosë Gjykata Supreme e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës lidhur me këtë çështje, duke pasur parasysh që në ankimin e parë nuk e ka ngritur si problem këtë çështje.

Standardi ligjor për vërtetimin e veprës penale të pastrimit të parave pa e identifikuar më parë veprën bazë është po ashtu i rëndësishëm. Në mënyrë specifike, në këtë rast gjykata nuk ka qenë në gjendje ta përcaktojë prej çfarë krimesh specifike e kishin prejardhjen paratë që ishin objekt i pastrimit dhe të cilat në fund u konfiskuan. Në vend të kësaj, gjykata, duke e përmendur konventën e sipërpërmendur, mori vendimin që, sipas nenit 9, një akuzë nuk duhet domosdoshmërisht të vërtetohet në mënyrë që të vërtetohet një vepër penale e pastrimit të parave në bazë të "rrethanave objektive faktike" që është një standard ligjor i vendosur i jurisprudencës. Mund të thuhet që këta janë faktorët që ndikojnë drejtpërdrejt në ekzistencën dhe përmbajtjen e të gjithë vendimit në këtë çështje dhe kanë pasojat të drejtpërdrejta në sekuestrimin e pasurisë së fituar (dhe të pastruar) në mënyrë të paligjshme.

Nëse në këtë rast është kryer krimi i pastrimit të parave dhe është lejuar zbatimi i drejtpërdrejtë i konventave ndërkombëtare, nuk do të jetë e nevojshme që në procesin gjyqësor të përcaktohet veprimtaria kriminale bazë nga e cila ka rrjedhur pasuria e dyshimtë. Pastaj do të ishte relativisht lehtë të mbrohet qëndrimi që e gjithë pasuria e dyshimtë i nënshtrohet konfiskimit të përhershëm, ashtu siç ka vendosur gjykata në vendimin e saj. Për këtë arsye, gjykata ka përmendur dispozitat përkatëse të Kodit Penal Federal (neni 272, paragrafi 4) si edhe Ligjin për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme (neni 10) në mënyrë që të arsyetojë konfiskimin e të gjithë pasurisë që i është nënshtruar pastrimit të parave.

Plotësimi i të gjitha supozimeve të sipërpërmendura do të krijonte një grup koherent, racional dhe shumë efektiv të standardeve ligjore që nuk do të lejonin konfiskimin e përhershëm të pasurisë me vlerë të lartë (përafërsisht 10 milionë euro) si përgjigje ndaj krimit të pastrimit të parave, por do të krijonte po ashtu një qëndrim të dobishëm dhe të nevojshëm ligjor lidhur me praktikën gjyqësore në të ardhmen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekst të luftimit të krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe të formave të tjera të rënda të krimit meqë këto janë fusha të politikave penale me prioritet të lartë në Bosnjë dhe Hercegovinë.

d. Lloji i pasurive të kthyera

Pas dhënies së dënimit, gjykata urdhëroi po ashtu sekuestrimin e pronës nga personat e dënuar, e cila përfshinte pasuri të ndryshme me vlerë të madhe. Pasuritë e sekuestruara përbëheshin nga: para kartmonedhë, aksione në një fond të hapur investimesh, kompani, prona të paluajtshme, automjete dhe artikuj të tjerë si mobilie dhe një sistem për ngrohje me diell.

3. Rast studimi për Kosovën* - Një rast i profilit të lartë i kthimit të pasurisë

Ky rast i konfiskimit është zgjedhur me qëllim që të konfirmohet efikasiteti në zbatimin e legjislacionit penal në Kosovë *, do të thotë të ligjeve pozitive, si: Kodi Penal (KPRK), Kodi i Procedurës Penale (KPPRK), Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, me qëllim që të ndëshkohet kriminaliteti dhe të parandalohen individët që të përfitojnë pasuri përmes aktiviteteve kriminale dhe të paligjshme, me theks të posaçëm në autorët e veprave penale. Në këtë rast autori ishte person i profilit të lartë.

Më 28 qershor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë dënoi ish-gjyqtarin K.P. me katër vjet burgim efektiv, me 5.000 euro gjobë dhe ndalim të ushtrimit të punës publike për tre vjet. Kjo ishte në lidhje me dënimin e tij për “nxjerrje të vendimeve të paligjshme”, neni 432 i KPPRK, “keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit” neni 422 i KPPRK, si dhe për “pastrim të parave”, neni 56, paragrafi 1, i Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit”. Ai u shfajësua për “shmangie të tatimit”, neni 313, paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 të KPPRK.

Pjesën më të madhe të vendimit të dhënë nga Gjykata e Themelit në Prishtinë e konfirmoi edhe gjykata e shkallës së dytë, e cila i vendosi te pandehurit një dënim më të butë, që do të thotë burgim me tre vjet dhe gjashtë muaj dhe një gjobë prej 3.000 euro.

Megjithatë, në një seancë të trupit gjykues të mbajtur më 15 maj 2018, Gjykata e Lartë e Kosovës* e aprovoi pjesërisht kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit K.P., dhe e anuloi pjesërisht vendimin e dhënë nga Gjykata e Themelit në Prishtinë dhe vendimin e Gjykatës së Apelit në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave, duke e kthyer këtë pjesë të çështjes në shkallën e parë.

Procesi gjyqësor në fjalë u zhvillua në pajtueshmëri me aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Kosovës *, PPS.NR.22/09, e cila ishte dorëzuar më 29 dhjetor 2015.

Sipas pikës 3 të aktakuzës, K.P. akuzohej për veprën penale të pastrimit të parave. Sipas kësaj aktakuze, gjatë periudhës 2002 - 2008, K.P. bleu një numër të pronave të ndryshme në vlerë prej 1.200.000€, përkundër faktit që ishte në dijeni se paratë ishin të ardhura nga aktiviteti kriminal, në mënyrë specifike me qëllim që të fshihej prejardhja e parave.

Në aktakuzë thuhet që K.P. i bleu dy apartamente në Klinë, lokale biznesi dhe një ndërtesë dy katëshe, dy parcela të tokës në Mal të zi dhe një apartament në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë.

Rasti kundër ish-gjyqtarit K.P. dhe pesë avokatëve, të cilën po ashtu po gjykohen për veprat penale lidhur me korrupsion dhe krim të organizuar, u transferua në Departamentin Special të Gjykatës së Themelit në Prishtinë.

Avokatët Z.M., L.P., I.S., F.M., B.N., ishin pjesë e aktakuzës së bashku me ish-gjyqtarin K.P. Tre të fundit ishin përfaqësues të kompanive të sigurimit.

Aktakuza e PSRK lidhur me këtë rast iu referohet veprave penale të "krimit të organizuar", "nxjerrjes së paligjshme të vendimeve", "keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autoriteti", "mashttrimi", në mes të veprave të tjera penale. Personat e akuzuar paditeshin për fitimin e më shumë se një milion eurove (1.200.00€) nga aktivitetet e paligjshme.

Aktakuza e parë lidhur me këtë rast është ngritur më 12 dhjetor 2013 dhe është saktësuar më 14 nëntor 2014, 30 qershor 2017 dhe 14 gusht 2017.

Sipas aktakuzës, të gjithë të pandehurit ishin anëtarë të një grupi të krimit të organizuar, viktimat të cilëve ishin kompanitë e sigurimit që funksionojnë në Kosovë*.

Sipas aktakuzës, grupi kriminal është krijuar, administruar, monitoruar dhe kontrolluar nga ish-gjyqtari i Klinës, K.P.

K.P., sipas aktakuzës, ia ka dalë mbanë të arrijë një marrëveshje me pjesëtarët e grupit kriminal që të fallsifikojë çështjet gjyqësore, të nxjerrë vendime të paligjshme, të fallsifikojë dokumente, të paraqesë fakte të rreme, të keqpërdorë pozitën zyrtare ose autoritetin, si edhe të mos i respektojë kompetencat gjyqësore. Kjo ka ndodhur me qëllim që të përfitojë në mënyrë të paligjshme shuma të mëdha të pasurive financiare shpejt dhe lehtë, në dëm të të tjerëve.

Sipas aktakuzës, K.P. e bëri një marrëveshje për fitim të paligjshëm me avokatët e akuzuar në këtë rast, të cilët ishin të parët në zinxhirin e aktivitetit kriminal, pas K.P.

Në aktakuzë thuhet që Z.M., e autorizoi K.P. të ketë akses në bankën e tij, duke operuar me shumën të mëdha të parave. Pastaj u arrit një marrëveshje me përfaqësuesit e kompanive të sigurimit si I.S., F.M. dhe B.N., në mënyrë që të pajtoheshin me vendimet e propozuara të K.P. gjatë seancave gjyqësore. Për më tepër, në aktakuzë thuhet që ishte krijuar po ashtu edhe një lidhje me mjekët specialistë, kryesisht ortopedë, si doktori B.B.

Sipas aktakuzës, ky aktivitet ka zgjatur prej vitit 2004 deri në vitin 2008. Sipas aktakuzës, për shkak të këtij aktiviteti, të pandehurit ndanë mes tyre në mënyrë të paligjshme shumën prej 1.225.927.93€. Në aktakuzë thuhet që veprimet e të gjithë të pandehurve përmbajnë elemente të veprës penale të krimit të organizuar.

K.P., u akuzua për nxjerrje të paligjshme të vendimeve gjyqësore dhe për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose autoritetit. Z.M. dhe L.P. u akuzuan për shkelje të besimit. F. M. dhe B.N. u akuzuan për mashtrim dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe I.S. u akuzua për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose autoritetit.

K.P. u akuzua njëkohësisht edhe në një rast tjetër penal dhe më 28 qershor 2017 u dënua nga Gjykata e Themelit në Prishtinë me 48 muaj burgim efektiv, një gjobë prej 5.000 eurove dhe ndalimin e kryerjes së funksioneve publike për tri vjet.

K.P. u shpall fajtor për tre prej katër pikave të aktakuzës. Në lidhje me pikën e parë, nxjerrja e paligjshme e vendimeve gjyqësore, K.P. u dënua dhe u ndëshkua me 18 muaj burgim. Në lidhje me pikën e dytë, keqpërdorim i pozitës zyrtare, K.P. u dënua dhe u ndëshkua me 24 muaj burgim. K.P. po ashtu u shpall fajtor në lidhje me pikën e tretë të aktakuzës, pastrim parash, dhe u ndëshkua me 18 muaj burgim dhe një gjobë prej 5.000.00€. K.P. nuk u shpall fajtor në lidhje me pikën e katërt, shmangie nga tatimi. Më 14 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit e vërtetoi burgimin e K.P..

Pasuria e fituar nga kryerja e veprave penale u vlerësua të jetë mbi një milion euro (1.000.000.00€). Në të përfshihej një banesë në Klinë, një banesë në Prishtinë, tokë në Ulqin në Mal të zi me sipërfaqe prej 308 m2, një livadh në Ulqin me sipërfaqe prej 171 m2, lokale biznesi në Klinë, një automjet të tipit "Audi A6", si edhe pasuri financiare të fituara nga shitja e dy lokaleve biznesi. Kjo pasuri u konfiskua nga i akuzuari.

Më 4 shkurt 2019, ish-gjyqtari K.P. u dënua nga Gjykata e Themelit në Prishtinë për pastrim të parave dhe u ndëshkua me një vjet burgim dhe një gjobë prej 3.000€. Vendimin e dha gjyqtari N.K. pas shpalljes fajtor të të pandehurit në bazë të faktit që gjatë vitit 2004-2008 K.P. bleu shumë prona, përkundër të qenit në dijeni që paratë ishin të ardhura nga një aktivitet kriminal dhe me qëllim që të fshihte prejardhjen e parave.

4. Rast studimi për Malin e zi – Konfiskim i zgjeruar

Përshkrimi i rastit

Ky rast u ngrit para Gjykatës së Lartë në Podgoricë kundër nëntë të pandehurve; tetë meshkujve dhe një femre. Shërbimi i Lartë i Prokurorisë në Podgoricë ngriti akuzë në lidhje me veprën penale të trafikimit të drogës.

Vendimi përfundimtar u dha në shtator 2016 dhe të pandehurit u shpallën fajtorë.

Llojet e pasurive të kthyera

Pas dhënies së vendimit përfundimtar dhe të zbatueshëm, gjykata njëkohësisht urdhëroi konfiskimin e pasurive të personave të dënuar.

Pasuritë në vijim u konfiskuan nga personat e dënuar:

Pasuri të Paluajtshme

- a. pasuri të paluajtshme e regjistruar në emër të njërit prej të pandehurve;
- b. pasuri të paluajtshme e regjistruar në degën e zyrës së Administratës për Pasuritë e Paluajtshme të Malit të Zi, komuna e Nikshiqit. Më saktësisht një apartament prej 64 m2.

Karakteristikat kryesore të hetimit financiar

Shërbimi i Lartë i Prokurorisë i Podgoricës e drejtoi hetimin financiar për të përcaktuar fitimet dhe pasuritë e fituara ligjërisht nga i pandehuri. Në lidhje me apartamentin e përmendur më sipër, gjatë hetimeve u mblodhën dëshmi që ai ishte fituar përmes aktivitetit kriminal, më saktësisht që i pandehuri nuk kishte fonde të mjaftueshme të fituara ligjërisht për blerjen e tij dhe vlera e apartamentit ishte në shpërpjesëtim të konsiderueshëm me të ardhurat e tij të fituara në mënyrë të ligjshme.

Është me rëndësi të theksohet që zbatimi i masave të fshehta të mbikëqyrjes gjatë procesit penal kundër të pandehurit kishin si rezultat mbledhjen e informacioneve të shënuara më sipër. Provat u siguruan nga një bisedë telefonike në të cilën i pandehuri kërkoi nga individë të caktuar të vërtetonin që ata i kishin huazuar para për blerjen e apartamentit të përmendur më sipër.

Çështjet përkatëse ligjore me rëndësi për kthimin e pasurisë

Pas dorëzimit të urdhrat për konfiskim për apartamentin e sipërpërmendur, gjykata, në perfundim të procesit, konstatoi që personi i dënuar nuk ishte në gjendje të argumentonte epërsinë e provave që apartamenti ishte fituar në mënyrë të ligjshme. Kështu që, pas krahasimit të të ardhurave të fituara në mënyrë të ligjshme dhe të shpenzimeve të personit të dënuar me vlerën e këtij apartamenti, gjykata konstatoi që ekzistonte një shpërpjesëtim i konsiderueshëm. Sigurisht që kishte dyshim të arsyeshëm që apartamenti ishte fituar përmes kryerjes së aktivitetit kriminal. Gjykata, në veçanti, përmendi faktin që personi i dënuar nuk kishte qenë kurrë i punësuar dhe që kurrë nuk kishte fituar të ardhura personale, dhe për shkak të kësaj ai nuk ka pasur mundësi ta sigurojë apartamentin prej 47.000€.

Më 26 janar 2019, Gjykata e Lartë e Podgoricës la në fuqi vendimin, duke ia konfiskuar personit të dënuar apartamentin. Më 1 prill 2019, u hodh poshtë ankesa e personit të dënuar, të cilën e kishte parashtruar avokati i tij mbrojtës, dhe si rezultat apartamenti u konfiskua.

5. Studim i rastit në Maqedoninë e Veriut – Konfiskimi i mjeteve dhe i të ardhurave nga krimi⁴

Kontrabandimi i duhanit dhe shmangia nga tatimi lidhur me këtë u përhap në masë të madhe në vitet e nëntëdhjeta dhe në fillim të vitit 2000, kështu që autoritetet maqedonase i kushtuan vëmendje të duhur marrjes me sfidat e parandalimit dhe ndëshkimit të këtyre krimeve. Përpunimi i suksesshëm i rastit të ashtuquajtur “Pepel” (“Hiri”) është përshkruar shkurtimisht në paragrafët në vijim.

Pas zbulimit të “mafias së duhanit” në qytetin Kumanovë të Maqedonisë së Veriut, e cila i shkaktoi dëm të madh buxhetit të shtetit,⁵ dhe bazuar në gjetjet e hetimit penal që nxorën në pah gjasat për një varg të veprave penale, Prokuroria Publike e Themelit në Shkup për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit më 2009 ngriti aktakuzë kundër 33 personave në Gjykatën Themelore Shkupi 1 – Shkup (gjykata e shkallës së parë) me akuzat për “Organizim kriminal” (neni 394(1) i Kodit Penal (KP)), “Keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autoritetit” (neni 353(4) i KP), “Tregti e paautorizuar e [...] prodhimeve të duhanit” (neni 60 i Aktit për akcizat) dhe/ose “[...] shfrytëzimi i

4 Rasti i studimit është përgatitur nga Zoran Gavriloski- Avokat dhe Konsulent Ligjor

5 Ministria e Brendshme, *Gjendja dhe rezultatet në zbulimin e rasteve të keqpërdorimit korruptiv të detyrës zyrtare 2007-2009*, 09.12.2009 (<http://arhiva.mvr.gov.mk/ShoëAnnouncements.aspx?ItemID=8011&mid=1094&tabl=201&tabindex=0>). Informacionet e ministries u referoheshin të 47 kryerësve të dyshuar të veprës dhe pohonin që dëmi i përgjithshëm arrinte në 55,3 milionë euro. Autoritetet zbuluan, në lokacione të ndryshme, më shumë se 20 tonë të cigareve të prodhuara në mënyrë të paligjshme (shih artikullin e Makfax, infra).

palejuar i firmës së dikujt tjetër” (neni 285(1) i KP)⁶ dhe po ashtu kërkoi konfiskimin e mjeteve dhe të ardhurave nga këto krime.

Në vitin 2010, gjykata e shkallës së parë nxori një vendim,⁷ duke konstatuar në këtë mënyrë që i pandehuri i parë B.S. në mesin e vitit 2006, pas blerjes së 59,95% të aksioneve të Kompanisë së Duhanit të Kumanovës (KDK), i vendosi personat e tij të favorizuar N.S. dhe R.R. në strukturat menaxhuese të kompanisë dhe së bashku me ta krijoi një grup kriminal me 20 të pandehur të tjerë, duke u përqendruar në tregtinë dhe shfrytëzimin e palejuar të markës tregtare të një firme tjetër përmes prodhimit të cigareve me cilësi të ulët pa leje për prodhim. Gjykata zbuloi se para tetorit 2008 nuk ishte paguar tatimi për cigare (akciza) në një shumë prej 6.57 milionë euro të barasvlershme në dinarë dhe që B.S. nxiti N.N. dhe M.Gj. ta keqpërdornin pozitën e tyre zyrtare dhe autoritetin në KDK duke urdhëruar pagesën prej 1.05 milion dollarëve amerikanë dhe 5.18 milionë eurove kompanisë së huaj “Sh.k” nga K., në bazë të faturave të nxjerra lidhur me kontratën e rreme të blerjes me atë kompani, edhe pse “Sh.k” nuk merrej me prodhimin e duhanit. B.S u dënua me pesë vjet burgim dhe u urdhërua ta paguajë një gjobë prej 25,200 euro, ndërsa sanksionet ndaj të pandehurve të tjerë ishin më të buta.

Në pajtim me dispozitat e përgjithshme të nenit 100-a (“Kushtet për konfiskimin e mjeteve”), i cili parashikon që askush nuk mund të mbajë ose të blejë objekte që e kanë prejardhjen prej kryerjes së një krimi ose që kishin për qëllim kryerjen krimin ose që ishin shfrytëzuar për ta kryer krimin (mjetet) dhe dispozitat specifike të nenit 285 dhe 394 të Kodit Penal lidhur me konfiskimin e mjeteve të krimeve të tyre përkatëse, gjykata e shkallës së parë urdhëroi konfiskimin në vijim: 77 filma të fotografisë – negative dhe 25 pllaka për shtypje (ofset) me mbishkrimet Marlboro, HB, MT, West, Ronson, Rodeo dhe të llojeve të tjera të cigareve të huaja; sasi të mëdha të cigareve, fleta të letrës për cigare dhe kuti të cigareve; mbështjellës, paketim nga kartoni dhe etiketa dhe shenja të kontrollit për lloje të ndryshme të cigareve me mbishkrimet përkatëse; makina për prodhimin dhe paketimin e cigareve; një numër të automjeteve (dhe të dokumenteve të tyre) që përdoren për transportimin e cigareve; shuma të mëdha të valutave të vendit dhe të huaja; shumë telefona celularë, kompjuter dhe paisje të tjera teknike, etj.

Në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 97 (“Konfiskimi i pasurisë dhe i të ardhurave nga krimi”) të Kodit Penal, i cili parashikon që askush nuk mund të mbajë ose të blejë të ardhura nga krimi, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për konfiskimin e të ardhurave nga krimet (i nxjerrë sipas nenit 97(2) të KP) kërkon:

- që të pandehurit e dënuar të paguajnë, në emër të solidarizimit (lidhur me kontributin e tyre në realizimin e përpjekjeve kriminale dhe të fitimit të pasurisë/sigurimit (e të ardhurave nga krimi)), një shumë të përgjithshme prej 6.57 milionë eurove në barasvlerën në denarë (e cila është e barasvlershme me shumën e papaguar të akcizës për mallra të duhanit), dhe nëse nuk do të mund të bëhej konfiskimi i shumës, do të konfiskohej pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme e kryesit të veprës, si edhe çdo pronë, pasuri, të drejta materiale ose jo materiale ose ndonjë pronë tjetër që përputhet me të ardhurat e fituara nga krimi; dhe
- subjekti juridik “Sh.k.” t’i paguante 1.05 milion dollarë amerikanë dhe 5.18 milionë euro (përfitim i paligjshëm pasuror i fituar nga pagesat në bazë të faturave të rreme në lidhje me shitjen jo-ekzistuese të duhanit KDK) dhe nëse nuk ishte i mundur konfiskimi i këtyre shumave të parave, do të konfiskohej pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme e autorit të veprës penale, si edhe çdo pronë tjetër, pasuri, e drejtë materiale ose jo materiale që përputhet me të ardhurat e fituara nga krimi.

6 I pandehuri i parë B.S. u akuzua (sipas aktakuzës Ko.nr.119/08 të datës 16 janar 2009) për veprat penale të përmendura më sipër, ndërsa 32 të pandehurit e tjerë u akuzuan për disa prej këtyre veprave penale.

7 Gjykata Themelore Shkupi 1 (Gjykata Penale) – Shkup, aktgjykimi V KOK.nr.3/09 i datës 25 mars 2010, tani përfundimtar (në dispozicion në: <https://www.akademik.mk/wp-content/uploads/2011/10/Presuda-pdf.pdf>), me anë të të cilit dënohen pjesa më e madhe të pandehurve.

Vendimi i Gjykatës së shcallës së parë u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit.⁸ Konfiskimi nuk u trajtua në vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ),⁹ e cila e rrëzoi pretendimin për pagesën e dëmeve në para në shumën prej 5,76 milionë euro, e cila pretendohet të kishte ndodhur me arsyetimin që B.S. nuk kishte mundur të ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për funksionimin e zakonshëm të kompanisë KDK deri sa ishte në paraburgim, sepse nuk kishte ndonjë lidhje shkakore ndërmjet shkëlqes së vërtetuar të të drejtës së B.S. për të qenë i lirë dhe dëmit të pretenduar në para.

Shqyrtimi i rasteve të “mafies së duhanit” në fund të vitit 2000¹⁰ duket të ketë pasur ndikim pozitiv në zvogëlimin e “ekonomisë së hirtë” të prodhimeve të duhanit (më 2010 katër herë më e vogël se më 2006¹¹) dhe në shmangien nga tatimi (2,5 herë më shumë tatime janë mbledhur më 2018 krahasuar me vitin 2010, sipas Ministrisë së Financave), përkundër vazhdimit të shmangies nga tatimi nga kontrabandimi i duhanit të papërpunuar.¹² Rrëfimi i suksesshëm maqedonas vërtetohet më tej me rezultatet e një studimi të fundit rajonal mbi tregtinë e paligjshme të cigareve dhe të produkteve të tjera të duhanit në Ballkanin Perëndimor.¹³

- 8 Makfax, “Gjykata e Apelit e ka konfirmuar dënimin e [B.S.]”, 16 mars 2011 (<https://makfax.com.mk/crna-hronika/249095/>).
- 9 Aktgjykimi i GJEDNJ në rastin S[...] v. [...] Republika e Maqedonisë, nr. 8784/11, 7 qershor 2018 (<https://hudoc.echr.coe.int/>), §§ 47 and 49.
- 10 Sipas TV “Kanal 5”, “Konfiskimi i pasurisë së kryesve të kimit të organizuar lidhur me duhanin”, 19 mars 2013 (<https://kanal5.com.mk/articles/168603/konfiskacija-na-imot-na-storitelite-na-organiziran-kriminal-so-tutun>), më 19 mars 2013 zëdhënësi i qeverisë njoftoi lidhur me konfiskimin e 56% të aksioneve të z. B.S. në KDK, si edhe një shume të konsiderueshme të parave (edhe disa prona të paluajtshme do të konfiskoheshin atëherë) dhe lidhur me konfiskimin e pasurisë së: personave të përfshirë në “Jaka tabak” Radovish, të cilët i shkaktuan shtetit dëme në shumën prej 2,5 milionë euro prej marsit 2001 deri në mars 2007; dhe të personave të përfshirë në Kompaninë e Duhanit në Prilep, të cilët i shkaktuan shtetit dëme prej 7 milionë eurove prej 1.1.2005 deri më 31.3.2006.
- 11 Ministria e Financave, “Maqedonia merret në mënyrë të suksesshme me kontrabandimin e organizuar të cigareve, ekonomia e hirtë u zvogëlua për 6%” (<https://www.finance.gov.mk/mk/node/1814>), një artikull pa datë, i cili ofronte informacione lidhur me zvogëlimin e aksioneve të ekonomisë së hirtë nga 25% (2006) në 6% (2010) u shoqërua me një rritje prej 80% të të ardhurave nga tregtia e paligjshme e prodhimeve të duhanit.
- 12 Teofil Blaževski, “Kontrabandimi i duhanit– shteti dhe tregu i ligjshëm humbin miliona euro”, në faqen e internetit të CSO Platforma për luftimin e korrupsionit, 2019 (<http://antikorupcija.mk/uploads/documents/3/Istrazuvacka%20storija%20-%20Teofil%20Blazevski.pdf>).
- 13 Projekti “Tregtia e paligjshme e prodhimeve të duhanit: Kontrabandimi qka ka ndodhur në rrugën ballkanike - BalkanSmugg” (i financuar nga PMI IMPACT dhe i zbatuar nga Instituti i Ekonomisë me seli në Zagreb prej korrikut 2017 deri në shtator 2019), objektivi specifik i të cilit ishte ofrimi i një baze të fuqishme të provave lidhur me tregtinë e paligjshme të duhanit në Slloveni, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi, Mal të zi, Maqedoni e Veriut dhe Kosovë*, rezultoi me publikimin e një studimi me emër të njëjtë (<https://eëë.eizg.hr/UserDocsImages/projekti/Balkansmugg/BalkanSmugg-Study.pdf>). Projekti e vlerësoi qëndrimin e duhanpirësve dhe praktikata e blerjes së cigareve në “tregun e zi” dhe të dhëna relevante u siguruan më 2018 duke e zhvilluar një anketë me 3,000 respondentë në secilin vend, me një numër të përgjithshëm prej 21,000 respondentëve në rajon.

	Kroacia	Sllovenia	BdheH	Serbia	Mali i zi	Maqedonia e Veriut	Kosova*
Tatimet e shmangura për shkak të kontrabandimit të duhanit, në miliona euro	59.22	8.55	129.07	64.72	23.28	6.24	15.69
Numri i plotë i tatimeve të pambledhura nga duhani, në % të BPV	0.2	0.1	0.9	0.2	0.6	0.1	0.2
Numri i plotë i tatimeve të pambledhura, si pjesë e shmangies së përgjithshme nga tatimi, në %	6.6	1.9	11.6	3.4	8.0	1.0	7.4

Edhe pse niveli i shmangies nga tatimi në Maqedoninë e Veriut për shkak të kontrabandës së duhanit është më i ulët në rajon, suksesi në marrjen me krimet specifike përmes, në mes tjerash, konfiskimit të të gjitha mjeteve dhe të ardhurave nga krimet, ende duhet të përshtatet me suksesin e përgjithshëm në përpunimin e rasteve të krimit të organizuar të nivelit të lartë (veçanërisht “të jakave të bardha”) në fusha të ndryshme.¹⁴

6. Rast studimi për Serbinë – Standardet e të provuarit

Ky rast konfiskimi është zgjedhur sepse ngre çështjen lidhur me mënyrën e vërtetimit të përvetësimit të ligjshëm të pasurisë nga ana e një personi të dënuar dhe zbatimin e ligjit që është më favorizues për të.

Për rastin në fund vendosi Gjykata e Lartë e Kasacionit, e cila vendosi lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, një mjet ndihmës i jashtëzakonshëm juridik. Procesi gjyqësor ka të bëjë me konfiskimin e pasurisë së një personi të dënuar, pasi vendimi i dhënë nga Departamenti Special Kundër Krimit të Organizuar mori formën e prerë.

Në vendimin e datës 13 prill 2017, Departamenti i Posaçëm kundër Krimit të Organizuar i Gjykatës së Lartë të Beogradit shpalli të pandehurin A.A. fajtor për mashtrim sipas nenit 208(4) të Kodit Penal në lidhje me paragrafin 1 të atij neni dhe për organizim kriminal sipas nenit 346(2) të Kodit Penal në periudhën prej Janar 2004-13 nëntor 2009. I pandehuri u ankua kundër vendimit në Departamentin të Posaçëm të Gjykatës së Apelit, i cili dha vendimin e tij më 5 mars 2018. Kjo gjykatë i mbështeti pjesërisht pretendimet e të pandehurit, e ndryshoi vendimin e shkallës së parë dhe e shpalli të pandehurin fajtor vetëm për mashtrim por jo për organizim kriminal. Sipas këtij vendimi të formës së prerë, i pandehuri u dënua me tre vjet e gjashtë muaj burgim dhe me një gjobë prej një milion dinarëve të RS (përafërsisht 8,500€).

14 Në rastin e ashtuquajtur “Besimi”, u ngrit pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme në vlerë prej rreth 14, 5 milionë eurove gjatë procedurës penale kundër pesë kompanive dhe krye shefave të tyre ekzekutivë të cilët, duke i keqpërdorur procedurat e tenderimit publik, i shkaktuan dëme buxhetit të shtetit në shumën prej 17 milionë eurove. Informacione lidhur me përpjekjet e bëra së fundi lidhur me konfiskimin nga ana e Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar mund të gjenden në artikullin e Svetlana Božinovska “Janë përgatitur vendimet për konfiskimin e pasurisë së S.K.”, TV “24 vesti”, 18 korrik 2019 (<https://www.24.mk/details/izgotveni-reshenija-za-konfiskacija-na-imot-na-sead-kochan>).

Pasi vendimi mori formën e prerë, Zëvendësprokurori për Krimin e Organizuar më 9 maj 2018 dorëzoi një mocion për konfiskimin e të ardhurave nga krimi që i takonin të pandehurit.

Sapo i përfundoi procedurat e konfiskimit, Departamenti i Posaçëm i Gjykatës së Lartë të Beogradit dha një vendim duke e mbështetur kërkesën e prokurorit dhe urdhëroi kryerjen e konfiskimit të pasurisë së të pandehurit, në veçanti: një apartament prej 218 m² në Beograd, një hapësirë të garazhit prej 12 m², dhe një parcelë të tokës prej 4,850 m² afër Beogradit. Detajet lidhur me pasurinë u saktësuan në vendim. Gjykata vendosi që pasurinë e konfiskuar ta administronte Drejtoria për Administrimin e Pasurisë deri sa vendimi të bëhej përfundimtar.

Gjykata e Apelit e Beogradit nxori një vendim më 30 janar 2019, dhe rrëzoi ankesën e të pandehurit duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Beogradit tregon që konkluzionet për faktet lidhur me apartamentin e konfiskuar gjatë procedurës së konfiskimit ishin të diskutueshme meqë gjykata e shkallës së parë i kishte rrëzuar pretendimet e të pandehurit dhe të dëshmitarit të tij B.B. dhe që ky i fundit e kishte blerë apartamentin nga i pari dhjetë vjet më parë dhe që i pandehuri nuk ishte pronar as i apartamentit as i garazhit.

Gjykata e Apelit u pajtua me gjykatën e shkallës së parë, e cila kishte ardhur në përfundim që analizimi i të gjitha provave të prezantuara, në veçanti i deklaratave të bëra nga dëshmitari B.B. dhe nga i pandehuri, si në procesin e sekuestrimit ashtu edhe në atë të konfiskimit, kishte treguar që kontrata për shitjen e pasurisë së paluajtshme, e lidhur ndërmjet të pandehurit dhe të dëshmitarit, nuk mund të konsiderohej e vlefshme me arsyetimin ligjor për përvetësim të pasurisë në këtë rast të posaçëm, sepse kontrata nuk ishte vërtetuar në gjykatë. Gjykata erdhi në këtë përfundim pas analizimit të fakteve, në veçanti të pretendimeve që i pandehuri ia kishte shitur apartamentin dëshmitarit në vitin 2009, por që ky i fundit as nuk ishte përpjekur ta vërtetonte kontratën, as ta regjistronte apartamentin në regjistrin e pasurive të paluajtshme, dhe vetëm në Qershor 2018 dëshmitari e paditi të pandehurin duke kërkuar që ai t'ia dorëzonte apartamentin në posedim ose t'ia kthente paratë që ia kishte dhënë për apartament. Gjykata e cilësoi deklaratën e dëshmitarit si jo bindëse, duke e pasur parasysh deklaratën e të pandehurit gjatë procedurës së sekuestrimit të vitit 2011, kur ai nuk e përmendi fare që ia kishte shitur apartamentin dëshmitarit; në të vërtetë, i pandehuri pastaj pohoi që e kishte blerë apartamentin ndërkohë që ishte në ndërtim e sipër, që nuk e kishte paguar atë akoma dhe që do të bëhej pronari i saj kur të kryhej ndërtimi dhe ta paguante çmimin e kontraktuar. I pandehuri e përmendi dëshmitarin për herë të parë në qershor 2018, gjatë procedurës së konfiskimit, prandaj gjykata konkludoi që të dyja, këto deklarata dhe pretendimet e dëshmitarit, ishin bërë për të penguar konfiskimin e apartamentit. Sipas një kontrate të vërtetuar të shitblerjes, i pandehuri e bleu apartamentin për €309,100 më 5 prill 2007.

Një analizë e tillë e fakteve nga ana e gjykatës është me rëndësi të madhe për praktikën gjyqësore vendase sepse të pandehurit në procesin për sekuestrim/konfiskim gjithnjë e më tepër janë duke dorëzuar në gjykata kontrata të pavërtetuara, së bashku me deklaratat e dëshmitarëve që e mbështesin vërtetësinë e tyre, prandaj ky rast është një ilustrim i shumë fakteve që gjykata i merr parasysh dhe për të cilat vendos. Praktika vendase gjyqësore lidhur me çështjet e tilla ende nuk është plotësisht e përshtatur.

Për më tepër, gjykata i rrëzoi pretendimet e të pandehurit që ai i kishte fituar €1,444,864 si bashkëpronar i një kompanie në Malin e zi prej vitit 1998 deri më 1 shtator 2009 dhe që me këto para e kishte blerë në mënyrë të ligjshme pronën e sekuestruar (avokati mbrojtës i të pandehurit kishte dashur të thërrasë të dëshmojë një ekspert financiar në mënyrë që të mbështeste këto pretendime). Gjykata konstatoi që gjatë procesit të sekuestrimit dhe të atij të konfiskimit i pandehuri nuk kishte paraqitur ndonjë provë të besueshme për mbështetjen e pretendimeve të tilla, ndërsa, në anën tjetër, prokurori kishte dorëzuar prova të besueshme, në mënyrë specifike akte noteriale për të ardhurat e

ligjshme të të pandehurit dhe të bashkëshortes së tij, duke e vërtetuar që vlera e pasurisë së fituar i tejkalonte në masë të madhe të ardhurat e ligjshme të të dyve së bashku. Gjykata konstatoi që, gjatë procesit të konfiskimit, i pandehuri nuk kishte mundur të dorëzojë në gjykatë dokumentet origjinale lidhur me funksionimin tregtar të kompanisë në Malin e zi, përfshirë regjistrat e saj në çfarëdo forme ose, në fakt, ndonjë dokument tjetër që e ka fuqinë e dokumenteve zyrtarë dhe do të provonte ekzistencën e veprimtarisë tregtare të kompanisë. Gjykata konstatoi që i pandehuri kishte dashur ta ftonte dëshmitarin ekspert për të zgjatur procesin, aq më tepër meqë, në bazë të një raporti të Administratës kundër Pastrimit të Parave të Ministrisë së Financave, u vërtetua që i pandehuri vërtetë e kishte bashkëthemeluar një kompani në Mal të zi, por që kompania e tillë ishte krijuar në gusht 2007 pasi që i pandehuri e kishte blerë apartamentin e kontestuar në Beograd.

Gjykata konstatoi që Prokuroria e kishte provuar ekzistencën e një shpërpjesëtimi të qartë ndërmjet vlerës së pasurisë së të pandehurit dhe të ardhurave të tij të ligjshme, të cilat, së bashku me faktin që ishte shpallur fajtor për mashtrim, treguan që pasuria e tij ishte e ardhur nga krimi.

Së fundi, i pandehuri pretendoi, si para Gjykatës së Apelit ashtu edhe para Gjykatës së Lartë të Kasacionit, që ishte shkelur ligji sepse në këtë rast ishte zbatuar Ligji mbi konfiskimin e të ardhurave nga krimi (LKAK) i vitit 2016 – dhe jo LKAK i vitit 2008. Ai pretendoi që KAK i vitit 2008, i cili ishte i vlefshëm në kohën kur ai e kreu krimin për të cilin ishte dënua, ishte më i favorshëm për të, sepse ai nuk vlente për veprën penale të mashtrimit sipas nenit 208(4) të Kodit Penal, krahasuar me LKAK të vitit 2016. Prandaj, i pandehuri pretendoi që shkelja e nenit 5 të Kodit Penal dhe e nenit 2 LKAK, do të thotë që në këtë rast nuk është zbatuar ligji më i favorshëm.

Si Gjykata e Apelit ashtu edhe Gjykata e Lartë e Kasacionit kishin qëndrim të njëjtë lidhur me këto pretendime të të pandehurit. Ato konstatuan se nuk ishin shkelur dispozitat për zbatimin e ligjit më të favorshëm. Sqarimi i Gjykatës lidhur me qëndrimin e saj është me rëndësi për praktikën gjyqësore vendase pasi është hera e parë që kjo çështje është ngritur në Gjykatën e Lartë të Kasacionit në Serbi, për të cilën ajo ka marrë vendim.

Të dy gjykatat mendonin që LKAK parashikonte dy procese të ndara, një për sekuestrimin dhe tjetri për konfiskimin e të ardhurave nga krimi. Sipas mendimit të tyre, efektet ligjore, rrethanat në të cilat sekuestrohet/konfiskohet pasuria dhe juridiksioni funksional i këtyre dy procedurave ishin të ndryshme dhe ato nuk vareshin nga njëra tjetra. LKAK parashikon që procesi i konfiskimit pason pasi vendimi të marrë formën e prerë, ndërkohë që procese të tilla zhvillohen ndarazi dhe mund të zhvillohen vetëm në situatën e caktuar procedurale. Prandaj, fillimi dhe zbatimi i procesit të konfiskimit është ekskluzivisht i lidhur me momentin e dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit për një krim referuar në nenin 2 të LKAK.

Prandaj, në procesin e konfiskimit vlen ligji që ka qenë i vlefshëm në kohën e dhënies së vendimit të formës së prerë. Duke pasur parasysh që prokurori ka kërkuar konfiskim më 9 maj 2018, pasi vendimii cili shpalli të pandehurin fajtor për mashtrim mori formën e prerë, u konstatua që Gjykata e ka zbatuar në mënyrë të drejtë LKAK 2016 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 94/2016), i cili, në nenin 2(1(4)), parashikon që, mes tjerash, ai vlen për veprën penale të mashtrimit referuar nenit 208(4) të Kodit Penal.

Shtojca 1 – Pasqyrë statistikore e të dhënave për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar në rajon

Shqipëria									
(të dhëna nga Gjykata për Krime të Rënda dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara)									
Tabela 1									
Viti	Numri i çështjeve në gjykata	Numri i çështjeve të përfunduara në gjykata	Numri i plotë i çështjeve në të cilat pasuria është ruajtur përkohësisht	Numri i urdhrave të sekuestros të ekzekutuar	Vlera e përfaqësuar e pasurisë së sekuestruar	Vlera e përfaqësuar e pronës së sekuestruar me qëllimin e konfiskimit të mëvonshëm në kohën e sekuestrimit	Numri i plotë i çështjeve në të cilat është kthyer pasuria përgjithmonë	Numri i urdhrave të konfiskimit të ekzekutuara	Vlera e përfaqësuar e pasurisë së kthyer në kohën e konfiskimit
2018	27	26	9	7	Total: 901,326,213.03 ALL, (7,268,759.78 Euro)	Total: 901,326,213.03 ALL, (7,268,759.78 Euro)	10	5	Total: 515,291,000.60 ALL (4,155,572.585 Euro)
2019 (1janar-30 qershor)	7	7	4	4	Total: 34,033,071.50 ALL (278,959.60 EURO)	Total: 34,033,071.50 ALL (278,959.60 EURO)	2	2	Total: 49,740,652.24 ALL (407,710.26 EURO)

Bosnja dhe Hercegovina

Tabela 2

Viti	Numri i plotë i çështjeve në gjykata	Numri i plotë i çështjeve të përfunduara në gjykata	Numri i plotë i çështjeve në të cilat pasuria është ruajtur përkohësisht	Numri i urdhrave të sekuestruara të ekzekutuara	Vlera e përafërt e pasurisë së sekuestruar	Vlera e përafërt e pronës së sekuestruar me qëllimin e konfiskimit të mëvonshëm në kohën e sekuestrimit	Numri i plotë i çështjeve në të cilat është kthyer pasuria përgjithmonë	Numri i urdhrave të konfiskimit të ekzekutuara	Vlera e përafërt e pasurisë së kthyer në kohën e konfiskimit
2018	160	33	54	54	1.494.434 EUR		33		377.159 EUR

Kosova*

Tabela 3

Raportet për të dhënat statistikore nga Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, Këshilli i Prokurorisë i Kosovës*

Viti	Numri i plotë i çështjeve në gjykata	Numri i plotë i çështjeve të përfunduara në gjykata	Numri i plotë i çështjeve në të cilat pasuria është ruajtur përkohësisht	Numri i urdhrave të sekuestruara të ekzekutuara	Vlera e përafërt e pasurisë së sekuestruar	Vlera e përafërt e pronës së sekuestruar me qëllimin e konfiskimit të mëvonshëm në kohën e sekuestrimit	Numri i plotë i çështjeve në të cilat është kthyer pasuria përgjithmonë	Numri i urdhrave të konfiskimit të ekzekutuara	Vlera e përafërt e pasurisë së kthyer në kohën e konfiskimit
2018	N/A	2	N/A	N/A	27,867,583.23 €	27,867,583.23 €	2	N/A	N/A
2019	57	2	57	N/A	2,118,537.47 €	2,118,537.47 €	2	N/A	N/A

Tabela 3a

Të dhënat statistikore lidhur me konfiskimin dhe sekuestrimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar

Viti	Sekuestrimi	Konfiskimi	Numri i plotë	Të kthyera
2018	€891,330.93	€54,318.66	€ 945,649.59	€ 42,760.00
2019	€102,276.68	€1,715.00	€103,991.68	

Administrata për Sekuestrimin dhe Konfiskimin e pasurive i ka ekzekutuar 32 vendime (19 për sekuestrim, 4 për konfiskim, 8 për kthim dhe 1 për shfrytëzim. Gjatë kësaj periudhe, janë mbajtur 3 (tre) ankande dhe janë realizuar të ardhura në shumën prej 19,460.

Mali i zi

Tabela 4

Periudha	Hetimet financiare	Lloji i veprave	Llojet e pasurive të sekuestruara dhe të bllokuara
janar-shtator 2019	Në 10 raste kundër 184 personave fizik 150 persona juridik	Pjesëmarrje në grup të krimit të organizuar; Pastrimi i parave; Evazion fiskal; Keqpërdorim i pozitës Kontrabandë; Mithçënie Terrorizëm	Ndërtesë e banimit, hotele, lokale afariste me sipërfaqe prej 212.392 m ² , një oborr 500 m ² , një bodrum prej 37 m ² , garazhi me sipërfaqe prej 522 m ² , tokë me sipërfaqe prej 113.278 m ² , letra me vlerë – më shumë se 138,719,016.00 aksione.

Tabela 4a

TË ARDHURAT NGA KONFISKIMI SIPAS MARRËVESHJEVE PËR PRANIMIN E FAJËSISË - 2016-2019

Nr	Lënda	Të ardhurat e konfiskuara
1.	"TRADEUNIQUE"	19 810 047.38 €
2.	"MM"	385 185.20 €
3.	"COPYRIGHT"	2 191 012.62 €
4.	"S. M"	1 096 000.00 €
5.	"GC"	3 842 766.69 €
6.	"GC"	2 254 585.24 €
7.	"Armenko"	100 000.00 €
8.	"I.B"	40 000.00 €
9.	"KLAP"	780 000.00 €
10.	"VARDAR"	1 490 000.00 €
11.	"POREZI II"	188 000.00 €
12.	"ZETA"	196 000.00 €
13.	Të tjera	157 000.00 €
	TOTAL:	32 530 897.13 €

Maqedonia e Veriut

Tabela 5

Nr.	Numri i lëndës	Lloji i veprës	Numri i personave pasuria e të cilëve është konfiskuar	Lloji i pasurisë/vlerës së konfiskuar
1.	KO Nr 3/13	Neni 215 dhe neni 273. i Kodit Penal	1	150 EUR
2.	KO Nr 139/14 KOKG Nr 5/17 nga 18.05.2017	Neni 394 (260 dhe 258) i Kodit Penal	1	5 000 EUR 1 revole 4 plumba
3.	KO Nr 43/15 KOKG Nr 46/17 nga 18.09.2017	Neni 394 (353)	4	1.003.067 MKD
Shuma e përgjithshme për 2017			6 persona	5 150 EUR 1.003.067 MKD 1 revole 4 plumba
1.	KO Nr 91/14 KOKG Nr 18/18 nga 03.12.2018	Neni 353	3	10.721.903 MKD
2.	KO Nr 38/16 KOKG Nr 20/18 nga 27.09.2018	Neni 418d	1	34.440 MKD
3.	KO Nr 97/12 KOKG Nr 9/17 nga 16.05.2018	Neni 394 (279 dhe 353)	12	64.799.250 MKD
4.	KO Nr 85/18	Neni 353	1	26.653.281 MKD
Shuma e përgjithshme për 2018:			16 persona	104.215.008 MKD

Serbia

Tabela 6

2018

Nr.	Institucioni gjyqësor	Lloji i veprës	Lloji i pasurisë	Vlera
1.	A. P. D.E. J. C.	Urdhri i TOK xxx/17 i 19 shkurt 2018	- 630,920.00 EUR - 50.00 USD - 3,480 AUD - 18,300 CZK - 40 ECD - 9,000.00 JPY - 60.00 HKD - 863.00 SGD - 2,985.00 CNY - 528,000.00 VND - 2,500.00 THB - 3,870,00 AUD	
2.	A.K. (i pandehur) M.K. (palë e tretë)	Beograd Gjykata e Lartë	Neni 346(3) KP	- tokë, Surçin - shtëpi në Beograd - MOTOÇIKLETË Honda -Veturë QUAD 350,000.00 RSD 1,024,899.99 RSD

3.	D.T. (i pandehur) V. T. (palë e tretë) M.T (i pandehur) L. S. (palë e tretë) M.N. (palë e tretë) O. N. (i pandehur)	Beograd Departamenti i Posaçëm i Gjykatës së Lartë	Neni346(5), 246(4) dhe 231(2) KP	- apartament në Çaçak - apartament në Çaçak - shtëpi në Çaçak - AUDI A8 - apartament në Beograd - apartament në Çaçak - apartament në Beograd - SKODA SUPERB - objekt afarist në Valevë - AUDI A6 - apartament në Çaçak	34,000.00 EUR 30,000.00 EUR 9,000,000.00 RSD 1,679,989.08 RSD 82,500.00 EUR 17,550.00 EUR 36,500.00 EUR 919,801.50 RSD 20,000.00 EUR 2,226,600.00 RSD 14,500.00 EUR
4.	Z.A. (i pandehur) V.I. (i pandehur)	Gjykata e lartë e Nishit	Arts. 214(3) and 229(3) CC	- shtëpi - 40 m2 - shtëpi - 100 m2 - objekt afarist - 72 m2; - 2 lokale afariste - 32 m2 dhe 40 m2 - ndërtesë - 90 m2 - shtëpi - 95 m2 dhe ndërtesë ndihmëse - 21m2 - apartament në Nish, - dy shtëpi - 60 m2 dhe 36 m2 dhe ndërtesë ndihmëse - 24 m2, me tokë ndërtimore ngjitur me ndërtesën - 105 m2 - apartament - 42 m2 - apartament - 30 m2 - lokal afarist - 195 m2; - apartament -175 m2 - apartament - 75 m2 - apartament - 67 m2 - apartament - 68 m2 - hapësirë e bodrumit: 8 m2 dhe lokale ndihmëse - 5 m2 - garzhë - 45 m2 - shtëpi - 68 m2, me ndërtesë ndihmëse, hapësira: 63 m2 dhe tokë përgjatë hapësirave Crni Vrh, - 70% të aksioneve në kompaninë XXX LLC - 4 shtëpi me sipërfaqe: 59.50 m2, 22.50 m2, 30.81 m2 dhe 123 m2; hapësira e përgjithshme:235.81 m2 - ndërtesë afariste - 138 m2 - ndërtesë afariste- 176 m2 - ndërtesë afariste – 95 m2	322,270.00 EUR (sipas kontratës së aksioneve të shitjes së kapitalit të datës 21 dhjetor 2017)
5.	B. G. (i pandehur)	Prokuroria e Novi Pazarit	Neni 229(3) KP	- 30,000.00 EUR	
6.	R.M (i pandehur) XX LLC (palë e tretë)	Prokuroria e Lartë e Nishit Gjykata e Lartë e Nishit	Neni 234(3) CC	-15,651 (53.34%) aksione të zakonshmenë XX LLC - 1,904 (6.48%) aksione të zakonshme XX LLC	Kontrata e aksioneve të shitjes së kapitalit, çmimi 51 miliardë RSD ose 553,766.37 EUR për 15,651 aksione ose 53.34538% aksione, me çmimin nominal për aksion në shumën prej 1,500.00 RSD

7.	G.R. (i pandehur)	Departamenti Special Anti- Korrupsion i Gjykatës së Lartë të Beogradit	Neni 367(1) KP	- 7,050.00 EUR - 500.00 USD - 190.00 HRK		
8.	O.M. (i pandehur)	Departamenti Kundër Krimin të Organizuar i Gjykatës së Lartë në Beograd	Neni 346(2) KP	- 27,706.33 EUR - 2,701.00 CHF		
9.	S.P. (i pandehur) S.P. (palë e tretë)	Gjykata e Lartë e Beogradit	Neni 234(3) KP	EKZEKUTIMET NË VIJIM E SIPËR - 12 kompani - Apartamente në Beograd - Apartamente në Shabac - CP në fshatin Provo dhe Vladimirci - Qendër kulturore në një fshat	6,000,000 EUR	
10.	I.P. (i pandehur) Z.P. (i pandehur)	Departamenti i Posaçëm Kundër Krimin të Organizuar i Gjykatës së Lartë të Beogradit	Neni 346(5) Neni 234(3) KP	- apartamente - apartament - 35 m2 - apartament - 31 m2 - tokë bujqësore - 2,54.26 hektarë - lokale afariste - 18 m2 - apartament - 38 m2 - shtëpi njëkatëshe - kafene - 89 m2 - lokale afariste - 19 m2	20,000 EUR 17,000 EUR 30,000 EUR 10,000 EUR 10,000 EUR 20,000 EUR 45,000 EUR 10,000 EUR	
11.	N.P. (palë e tretë)	Departamenti i Posaçëm i Gjykatës së Lartë të Beogradit	Neni 346(2) dhe 234(3) KP	apartament, sipërfaqe: 55 m2	37,000 EUR	
12.	P.B. (i pandehur)	Gjykata e Faktit e Jagodinës	Neni 225(3) dhe 229(2) dhe 3) KP	-ndërtesë banimi - afariste, sipërfaqja e katit: 124 m2 -ndërtesë banimi-afariste, dy ndërtesa ndihmëse një katëshe, sipërfaqja: 98 m2, 22 m2 dhe 12 m2 - 3 fusha të tenisit - lokale afariste, sipërfaqja: 28 m2 - 3 apartamente në një vend turistik	50,000 EUR 30,000 EUR 20,000 EUR 80,000 EUR	E kthyer sipas vendimit xx/19 të Gjykatës Themelore të Jagodinës xx/19
2019						
1.	I.I. (i pandehur)	Departamenti i Posaçëm Kundër Krimin të Organizuar i Gjykatës së Lartë të Beogradit sipas kërkesës së Italisë	Pjesëmarrje në kryerjen e krimin të organizimit të paligjshëm të lojërave sipas nenit 4 të Ligjit italian nr. 401/89 dhe pastrimit të parave sipas nenit 648 të Kodit Penal të Italisë	2 apartamente	550,000 EUR 350,000 EUR	

2.	M.S/ (palë e tretë)	Departamenti i Posaçëm Kundër Krimin të Organizuar i Gjykatës së Lartë të Beogradit	Neni 346(5) dhe 234(1) KP	Apartament - 80 m2	40,000 EUR
3.	S.S M.S. M.S. D.S M.S	Departamenti i Posaçëm Kundër Krimin të Organizuar i Gjykatës së Lartë të Beogradit	Neni 346(5) dhe 234(3) KP	- ndërtesë familjare-e banimit - lokale afariste -apartament - 61 m2 dhe garazhë - 21 m2 -apartament - 23 m2 - lokale afariste -174 m2 - depozita bankare prej 10,000.00 EUR dhe 34,545.34 EUR - Mercedes Benz - Motoçikletë Vespa - 2 lokale afariste - sipërfaqja: 199 m2 dhe 120 m2 - depozitë bankare prej 10,018.18 EUR - lokale afariste - 298 m2 - ndërtesë familjare e banimit një katëshe sipërfaqja: 95 m2, ndërtesë ndihmëse, sipërfaqja: 110 m2, dhe ndërtesë ndihmëse sipërfaqja: 35 m2 -lokale afariste - 26 m2 - lokale afariste - 48 m2 - lokale afariste - 90 m2 - lokale afariste - 40 m2 -2 apartamente - 35 m2 secila - 2 lokale afariste - 35 m2 secila - 16 apartamente në ndërtesën e banimit-afariste - 35 m2 secila	
4.	S.S (i pandehur) J.S. (palë e tretë) M.S. (palë e tretë)	Gjykata e Lartë e Novi Sadit, Departamenti Special Anti -Korrupsion	Neni 231(2) KP	-apartament - 164 m2 -garazhë - tokë, sipërfaqja: 9 ari dhe 45 m2, me një vilë, sipërfaqja: 42 m2 - apartament -120 m2 - apartament -134 m2 - garazhë - 16 m2 - tokë, sipërfaqja: 13 ari dhe 4 m2, me tri ndërtesa një katëshe, sipërfaqja: 120 m2, 17 m2 dhe 49 m2	180,000 EUR 7,000 EUR 8,000 EUR 120,000 EUR 135,000 EUR 8,000 EUR
5.	G.M. (i pandehur) S.M. (i pandehur)	Gjykata e Lartë e Krlevës, Departamenti i Posaçëm Anti- Korrupsion	Neni 227(3) KP	- apartament - 58 m2 - ndërtesë tregtare -126 m2 - lokale afariste - 73 m2 - apartament - 85.02 m2	30,000 EUR 70,000 EUR 38,000 EUR 180,000 EUR
6.	D.M. (i pandehur) D.M. (palë e tretë)	Departamenti i Posaçëm Kundër Krimin të Organizuar i Gjykatës së Lartë të Beogradit	Neni 346(5) dhe 234(3) KP	-tokë, sipërfaqja: 0,05.35 hektarë dhe një ndërtesë familjare banimi një katëshe - 42 m2 - apartament - 42 m2	20,000 EUR 20,000 EUR
7.	D.D. (i dyshuar)	Prokuroria e Lartë e Beogradit	Neni 245(2) KP	-958,115 EUR kartmonedhë	

Referencat

- Bullock, K. (2010). Zbatimi i Sanksioneve Financiare: Rasti i Urdhrave të Konfiskimit. *The Howard Journal*, 49(4), faqe 328-339;
- Bullock, K., Mann, D., Street, R. & Coxon, C. (2009). *Shqyrtimi i dobësimit të konfiskimit të të ardhurave nga krimi* (Research Report 17). Londër: Home Office;
- Qendra për Studimin e Demokracisë (2014). *Shitja e Pasurive të Konfiskuara në Shtetet Anëtare të BE-së – Ligjet dhe Praktikën*. Sofje: CSD;
- Chistyakova, Y., Wall, S. D., & Bonino, S. (2019). *Drejtimi i Fshehtë i Krimit: Konfiskimi i Pasurive Kriminale në MB*. Revista Evropiane për Politika dhe Kërkime Penale, faqe 1-21;
- Datzer, D. & Mujanović, E. (2017). Metodologjia për mbledhjen e të dhënave lidhur me procedurat e kthimit në Bosnjë dhe Hercegovinë. Dorëshkrim i papublikuar;
- Europol (2016). *A shpaguhet krimi ende? Kthimi i Pasurisë Kriminale në BE (studim për informacionet statistikore)*. Hagë: Zyra e Policisë Evropiane;
- FATF (2012). *Standardet Ndërkombëtare për Luftimin e Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit & Përhapja e shpejtë*. Paris: FATF;
- Misoski, B. (2018). Ndikimi i Direktivës së BE-së 2014/42/EU mbi Ngrirjen dhe Konfiskimin e Mjeteve dhe të Ardhurave nga Krimi në Sistemin Maqedonas të Drejtësisë Penale, në *Kontekst të së Drejtës së BE-së – Përshatja për Anëtarësim dhe Sfidat e Zgjerimit* (eds. Duić, D. & Petrašević, D.). Osijek: Fakulteti i Drejtësisë, faqe 355-374;
- OECD (2018). *Vlerësim dhe Rishikimi i Organizimit Institucional për Kthimin e Pasurisë në Greqi* Paris: OECD;
- Università degli Studi di Trento (2018). *Shpagimi – Drejt një Sistemi të BE-së për Administrimin e të Dhënave për Pasuritë e Sekuestruara*. Torino: Autor;
- Vettori, B. (2006). *Të rreptë ndaj Pasurisë Kriminale. Shqyrtimi i Praktikës së të Ardhurave nga Konfiskimi i Krimit në BE*. Dordrecht: Springer;



Realizimin e këtij publikimi e ka mbështetur Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar
Mendimet e shprehura në këtë publikim nuk i shprehin detyrimisht mendimet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar

Qendra AIRE

Qendra AIRE është organizatë jo-qeveritare e cila promovon zbatimin e te Drejtës Evropiane dhe ofron mbështetje për viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut. Një ekip i juristëve ndërkombëtarë ofron ekspertizë, dhe këshilla praktike në lidhje me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës dhe ka përvojë të posaçme në çështjet gjyqësore në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, ku ka marrë pjesë në më shumë se 150 raste.

Gjatë këtyre 20 viteve, Qendra AIRE ka ndërtuar reputacionin e saj në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke vepruar në të gjitha nivelet sistemit të drejtësisë në rajon. Ajo punon në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e drejtësisë, shkollat e trajnimit të gjyqtarëve dhe gjykatat e larta dhe kushtetuese për të drejtuar, ndihmuar, mbështetur dhe ndihmuar në drejtim të zhvillimit të shtetit ligjor dhe projekteve të reformave në terma afatgjatë. Gjithashtu, Qendra AIRE bashkëpunon me sektorin e organizatave jo-qeveritare në mbarë rajonin me qëllim mbështetjen e reformave në fushën e ligjit dhe të respektimit të të drejtave të njeriut. Puna e organizatës ka qenë gjithmonë e përqendruar në garantimin që secili mundet praktikisht dhe efektivisht të gëzojë të drejtat e tij. Në praktikë kjo do të thotë promovim dhe lehtësim në zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke ndihmuar në procesin e Integritetit Evropian përmes forcimit të shtetit të së drejtës dhe garantimit të njohjes së plotë të të drejtave të njeriut, dhe inkurajimit të bashkëpunimit mes gjyqtarëve dhe profesionistëve në fushën e së drejtës në mbarë rajonin.

RAI

Nisma Rajonale Anti-Korrupsion (RAI) është një organizatë ndër-qeveritare me nëntë vende anëtare: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Mali i zi, Rumania dhe Serbia. Polonia, Gjeorgjia dhe Sllovenia janë vende të cilat e kanë statusin e vëzhguesit. Misioni i RAI është udhëheqja e bashkëpunimit rajonal për mbështetjen e përpjekjeve kundër korrupsionit duke ofruar një platformë të përbashkët për diskutime përmes ndarjes së njohurive dhe të praktikave më të mira. Sekretaria e Organizatës e ka selinë në Sarajevë, ndërsa ka projekte në mbarë Evropën Juglindore, duke u përqendruar në radhë të parë në forcimin e bashkëpunimit rajonal për konfliktin e interesit dhe deklarimin e pasurisë, në legjisllacionin me masa paraprake parandaluese kundër korrupsionit, vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni, sinjalizuesit, krijimin e integritetit të zbatuesve të ligjit dhe forcimin e kapaciteteve vendase për kthimin e pasurisë.